

ANALIZA GJINORE E PROJEKTIT

Për projektin: Trajnim profesional dhe mundësi për gjenerimin e
të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në
zonat rurale të Kosovës

Gusht, 2020

Përmbajtja

Lista e figurave.....	Error! Bookmark not defined.
Shkurtesat.....	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhja Ekzekutive	3
Metodologjia e hulumtimit	Error! Bookmark not defined.
Rekomandimet kyqe për projektin	Error! Bookmark not defined.
Hyrje.....	Error! Bookmark not defined.
Metodologjia e hulumtimi për analizë gjinore të projektit	7
Rishikimi i literaturës	8
Intervistat me akterët kyq komunal	8
Anketa familjare	8
Diksutimet e fokus grupeve	9
Profili i komunës.....	Error! Bookmark not defined.
Të gjeturat e hulumtimit	10
Rishikimi i literaturës	11
Qasja dhe kontrolli në resurse.....	11
Marrja e kredive	14
Pjesëmarrja.....	15
Ndarja e punës.....	Error! Bookmark not defined.
Vendimmarrja në familje	18
Normat sociale dhe kulturore lidhur me ndarjen e resurseve	19
Ndikimi pandemisë në situatën ekonomike të familjeve	20
Të gjeturat nga intervistat me akterët kyq	11
Të gjeturat nga fokus grupet	21
Konkludim dhe rekomandimet.....	23
Përkrahja e grave në bujqësi.....	23
Përkrahja e të rinjve në bujqësi	27
Shtojca 1 – Referencat.....	29
Shtojca 2 – Lista e intervistave nga anketa familjare	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 3 – Lista e intervistave me akterë kyq komunal	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 4 - Pyetësi i anketës familjare.....	29
Shtojca 5 – Pyetësi për institucionet në nivelin lokal	36
Shtojca 6 – Pyetësi për organizata e shoqërisë civile në nivel komunal	37

Lista e figurave

Figure 1. Pronësia e tokës bujqësore

Figure 2. Barrierat kryesore që parandalojnë pjesëmarrjen aktive të grave në bujqësi

Figure 3. Çka ju nevojitet për të rritur të ardhurat tuaja?

Figure 4. Shpërndarja e granteve, e ndarë në bazë të gjinisë

Shkurtesat

IADK	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ZBGJ	Zyrtari/ja për Barazi Gjinore
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
DKP	Drejtoria Komunale e Pylltarisë

Hulumtimi është realizuar nga konsulentja Linda Abazi-Morina.

Shënim: Raporti original është shkruar në anglisht. Përmbajtja dhe rekomandimet e prezantuara në raport janë të konsulentës dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të IADK-së dhe cfd-së.

Përmbledhja Ekzekutive

Qëllimet kryesore të këtij hulumtimi janë kryerja e një analize gjinore të projektit përmes hulumtimit të pabarazive gjinore dhe pengesave që lidhen me rolet gjinore dhe implikimet e saj për gratë, burrat, djemtë dhe vajzat në komunën e Vushtrisë dhe Lipjanit. Raporti synon gjithashtu zgjedhjen e fushave kryesore për nga rëndësia dhe analizimin e tyre sipas dimensionit personal, strukturor dhe të marrëdhënies, ndërsa analizon nevojat praktike dhe interesat strategjike.

Për më tepër, analiza synon të ofrojë rekomandime konkrete për hartimin e ndërhyrjeve në projektet e ardhshme, duke përcaktuar se cilat ndryshime duhet të parashikohen për të adresuar pabarazitë dhe pengesat e identifikuara në fushat e zgjedhura me përparësi, të përcaktoj kontributin e projektit për të arritur këto ndryshime dhe përshtatjet e nevojshme për dizajnimin e projektit të ardhshëm.

Hulumtimi është pjesë e projektit "Trajnimi profesional dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës", i implementuar nga IADK dhe i mbështetur nga CFD. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që gratë, burrat, të rinjtë dhe minoritetet që jetojnë në zonat rurale të trajtohen në mënyrë të barabartë sa i përket mundësive të punësimit, gjenerimit të të ardhurave dhe më saktësisht në drejtim të ndërgjegjësimit dhe shfrytëzimit të të drejtave të tyre.

Projekti ka tre rezultate: 1) Gjenerimi i të ardhurave për gratë që jetojnë në zona rurale është rritur; 2) Punësueshmëria dhe vendet e punës të grave dhe të rinjve në sektorin e bujqësisë janë rritur; 3) Ndërgjegjësimi i grave për të drejtat e tyre është ngritur dhe është rritur angazhimi i tyre në vendimmarrje në bashkësi dhe komunitet.

Hulumtimi u përqëndrua në rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të grave dhe burrave, dhe se si ato lidhen me njëri-tjetrin në njësitë shtëpiake, dhe zbatuan kornizën konceptuale 'katër fusha' për të udhëhequr hetimin e tyre: 1) Pjesëmarrja, 2) Qasja dhe kontrolli mbi burimet dhe pasuritë, 3) Divizioni i punës dhe, 4) Vendimmarrja.

Përderisa gratë shpenzojnë kohë, aftësi dhe punë në punën në bujqësi, dihet pak për specifikat e kontributeve të tyre. Hapi i parë për të siguruar që politikat dhe programet të përfshijnë dhe synojnë gratë në mënyrë efektive është të portretizojë saktësisht se cilat janë karakteristikat e tyre, duke marrë parasysh moshën dhe arsimimin e tyre; pronësinë e tokës; rolet dhe përgjegjësitë brenda familjes dhe punën në bujqësi, roli në familje si dhe qasja në përdorimin e burimeve dhe mundësive për zhvillim dhe rritje të shkathtësive profesionale.

Metodologjia e hulumtimit

Nisur nga situata me COVID-19, shpërthimi i pandemisë, hulumtimi në terren i planifikuar fillimisht për të filluar në prill 2020, duhej të shtyhej. Procesi i hulumtimit dhe mbledhjes së të dhënave në terren u realizua në fund të majit dhe në fillim të qershorit 2020, duke filluar me takime me përfaqësuesit e Drejtorive Komunale të Bujqësisë në dy komunat përkatëse. Intervistat po ashtu u realizuan me Zyrtarët për Barazi Gjinore dhe përfaqësues të OJQ-ve në nivel lokal. Për të marrë informacion të detajuar nga terreni, anketa familjare përmes intervistave është realizuar në të dy komunat, duke synuar grate përfituese të projektit dhe në përgjithësi gratë që punojnë në bujqësi.

Të gjeturat kryesore nga intervistat me akterët kyq në nivel komunal:

- Njohuritë rreth rolit të grave në bujqësi ishin solide nga zyrtarët komunal. Sidoqoftë, Zyrtarët për Barazi Gjinore në nivelin komunal dhe OJQ-të lokale kanë informacion të limituar për nivelin e përfshirjes së grave në aktivitetet bujqësore në komunat e tyre.
- Ka mungesë pothuajse totale të përfshirjes së Zyrtarëve për Barazi Gjinore në proceset e hartimit të politikave në nivelin komunal. Për më shumë, zyrtaret në fjalë nuk janë konsultuar për çështje bujqësore dhe nuk janë pjesë e "panelit të përzgjedhjes së granteve" brenda komunës.
- Nuk ka të dhëna të ndara në bazë të gjinisë në drejtoritë komunale të bujqësisë. Përveç mungesës së kohës dhe burimeve njerëzore, ka edhe një mungesë të ndjeshmërisë gjinore tek stafi, e cila duhet të adresohet.
- Në Lipjan janë pezulluar masat positive/afirmative për gratë aplikuese për grante. Sipas stafit këto masa pozitive janë keqpërdorur në mesin e aplikantëve në të kaluarën, kur në fakt, gratë nuk kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt në këto aktivitete bujqësore, për të cilat kanë aplikuar.

Të gjeturat kryesore nga anketa familjare:

- Shumica e grave të intervistuar janë të papuna, duke mos kërkuar punë. Ata nuk e konsiderojnë veten konkurruese në tregun e punës, dhe të punuarit jashtë shtëpisë nuk është një mundësi që ato e konsiderojnë, kryesisht për shkak të detyrave dhe përgjegjësisë që kanë të bëjnë me punët e shtëpisë.
- Sa i përket moshës, shumica e grave që punojnë në bujqësi janë zakonisht nga 40 deri në 55 vjeç. Ekziston një hezitim i gjeneratave të reja për të punuar në bujqësi, një çështje që do të diskutohet në detaje përgjatë raportit.
- Shumica absolute e pronarëve të tokave bujqësore janë burra. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve toka është në emër personave që nuk janë gjallë (d.m.th. vjehri, ose anëtarët tjerë të familjes si kushërinjtë).
- Në dy komunat, vetëm tri gra janë identifikuar si pronare të bizneseve të regjistruara dhe që posedojnë të ashtuquajturin NIF (Numri Identifikues i Fermës); një me serrë, një me kafshë, dhe një me bletari.
- Shumica e grave mendojnë se një burrë duhet të marrë pjesë në emër të familjes në takimet në fshat që lidhen me bujqësinë, duke pasur parasysh që ata nuk janë të angazhuar në punët shtëpiake dhe kanë më shumë kohë të lirë. Sidoqoftë, shumica e grave do të mund të merrnin pjesë nëse do të ishte e nevojshme.
- Një numër i konsiderueshëm i grave janë të interesuara për të zgjeruar punën e tyre në bujqësi, kryesisht në serë. Për më tepër, shumë gra shprehën interesim për zhvillimin e biznesit në bletari dhe prodhimin e mjaltit, veçanërisht ato që jetojnë në zonat më të largëta, afër pyjeve.
- Duke pasur parasysh që një numër i konsiderueshëm i familjeve nuk i shesin produktet e tyre, por i kultivojnë ato kryesisht për konsum familjar, analiza e kontrollit mbi paratë e fituara nga këto produkte është e kufizuar. Sidoqoftë, shumica e të anketuarve mendojnë se kontrolli duhet të ndahet mes anëtarëve të familjes dhe se burrat kanë më shumë fuqi vendimmarrëse në vendime, të cilat konsiderohen të vështira dhe vendimtare për familjen.

- Një nga vështirësitë më të shpeshta me të cilat përballen gratë dhe burrat në zonat rurale është që produktet e tyre blihen me çmime të ulëta, dhe tregu nuk është i qëndrueshëm.
- Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve mendojnë se pajisjet dhe mjetet e punës janë shumë të rëndësishme, veçanërisht për familjet që punojnë në serra, siç janë kultivatorët.
- Të dhënat e anketës familjare tregojnë se pjesëmarrja e grave në takimet ku burrat janë të pranishëm, nuk duket se është problem. Shumica e grave (97%) nuk do të hezitonin të merrnin pjesë në takimet ku ka burra të pranishëm.
- Në rastet kur familjet përfitojnë pajisje bujqësore, zakonisht e lehtësojnë punën e burrave, siç janë traktorët dhe pajisjet e tjera të rënda për punën në bujqësi. Në të kundërtën, puna e grave mbetet manuale, e vazhdueshme dhe kërkon shumë kohë, e gjë që kontribuon në orarin e tyre të gjatë të punës.
- Gratë janë të shqetësuara për fitimet që mund të nxjerrin nga aktivitetet e tyre bujqësore dhe janë të interesuara që të ndjekin aktivitete shtesë që shihen si mundësi për të krijuar dhe për të rritur të ardhurat në bujqësi.

Rekomandimet kyqe për njësinë implementuese të projektit:

- IADK mund të mbështesë drejtoritë e bujqësisë për të integruar analizën gjinore dhe të dhënave ndara në bazë të gjinisë në raportet dhe planet e saj, duke e implementuar këtë praktikë në të gjitha përpjekjet dhe programet e bujqësisë.
- IADK duke përdorur gjetjet e mbledhura nga kjo analizë mund t'i rekomandojë drejtorive të bujqësisë që të vazhdojnë të aplikojnë masat afirmative, çdo herë që të jetë e mundur për të rritur numrin e grave përfituese.
- Projekti mund të avokojë tek drejtoritë e bujqësisë për të rritur pjesëmarrjen e grave në takime, për çështje që lidhen me bujqësinë.
- Projekti mund të përkrahë drejtoritë komunale të bujqësisë që të kenë qasje më të lehtë të grave në bujqësi, duke ofruar përkrahje në krijimin e asociacioneve të grave që punojnë në bujqësi. Ndoshta IADK mund të institucionalizoj këtë përmes ofrimit të bashkëpunimit me drejtoritë e bujqësisë në komunat përkatëse për të zhvilluar këto asociaione, kështu që ato të vazhdojnë të funksionojnë edhe pasi të përfundoj projekti.

Hyrje

Bujqësia ka potencial të jetë një sektor shumë i rëndësishëm i ekonomisë, dhe një burim të ardhurash për një numër të familjeve në Kosovë. Të dhënat zyrtare të siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se punësimi në këtë sektor (Bujqësi, Pylltari dhe Peshkim) është vetëm 4.1 përqind, ku gratë përbëjnë vetëm 0.6 përqind. Është e qartë se ky sektor duhet të rigjallërohet, dhe duhet të shihet si një nga komponentët kryesorë të përpjekjeve qendrore dhe lokale drejt vetë-mjaftueshmërisë së ushqimit dhe zbutjes së varfërisë.

Gratë janë të përfshira në të gjitha aktivitetet në sektorin e bujqësisë; mirëpo, megjithëse shërbejnë si shtyllë kurrizore e këtij sektori, shpesh ato janë të marginalizuara dhe kanë më pak qasje në burimet financiare, njohuri dhe teknologji për të përmirësuar jetesën e tyre.

Mungesa e të dhënave dhe informacioneve të ndara sipas gjinisë në bujqësi paraqet një sfidë për hartimin e një sistemi të ndjeshëm gjinore të monitorimit dhe vlerësimit. Ky hendek është problematik për planifikimin e politikave sepse këto lloj të dhënash dhe informacione janë të domosdoshme për zhvillimin e politikave të bazuara në heterogjenitetin e komuniteteve lokale, duke përfshirë rolet gjinore, gëzimin e të drejtave, shqetësimeve dhe qasjen në mundësi të ndryshme zhvillimi. Për shkak të mungesës së të dhënave, rolet e mundshme të grave në bujqësi kurrë nuk janë diskutuar plotësisht, dhe as nuk është përcaktuar niveli i saktë i pjesëmarrjes së tyre.

Gratë mund të luajnë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin rural, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë, e sidomos gratë e zonave rurale, mirëqenia ekonomike e të cilave varet nga burimet bujqësore, duke dhënë një kontribut thelbësor në përmirësimin e jetesës familjare përmes shfrytëzimit të burimeve bujqësore. Gjetjet e mbledhura nga hulumtimi në terren tregojnë se gratë janë shumë të interesuara të punojnë në bujqësi, madje edhe më shumë sesa që punojnë aktualisht.

Projekti "Trajnim profesional dhe mundësi gjeneruese të të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës", i implementuar nga IADK dhe mbështetur nga *cfd* ka për qëllim që gratë, burrat, të rinjtë dhe minoritarët që jetojnë në zonat rurale të trajtohen në mënyrë të barabartë sa i përket mundësive të punësimit, gjenerimit të të ardhurave dhe më saktësisht në drejtim të vetëdijësimit dhe shfrytëzimit të të drejtave të tyre.

Kjo analizë siguron informacion domethënës për rolin e grave në bujqësi. Ajo tregon rolin e rëndësishëm të tokës bujqësore në komunat e zgjedhura. Për më shumë, ofron rekomandime konkrete për projektin se si të mbështetet fuqizimi ekonomik i grave rurale përmes diversifikimit të të ardhurave në bujqësi, dhe si të promovohet bujqësia tek të rinjtë.

Metodologjia e hulumtimit të analizës gjinore të projektit

Objektivat specifike të analizës gjinore janë:

a) Kryej një analizë gjinore të bazuar në projekt përmes:

- Hulumtim të pabarazive gjinore dhe pengesave në lidhje me rolet gjinore dhe implikimet e saj për gratë, burrat, djemtë dhe vajzat në një numër të zgjedhur të komunave të synuara të projektit;
- Përzgjedhjes së fushave kryesore me përparësi dhe analizimi i tyre sipas një dimensionit personal, strukturor dhe marrëdhënies;
- Analizimit të nevojave praktike dhe interesit strategjik.

b) Ofroj rekomandime konkrete për hartimin e ndërhyrjeve në projektin e ardhshëm, përmes:

- Përcaktimit të ndryshimeve (teoria e ndryshimit) duhet të parashikohet në mënyrë që të adresohen pabarazitë dhe pengesat e identifikuara në fushat e zgjedhura me përparësi;
- Përcaktimit të kontributit të projektit (qëllimi i projektit) për të arritur këto ndryshime;
- Përcaktimit të të gjitha përshtatjeve të nevojshme për hartimin e projektit të ardhshëm.

Rishikimi i literaturës

Rishikimi i literaturës përfshin rishikimin e hollësishëm të dokumenteve përkatëse të projektit. Për më shumë është rishikuar literatura e fundit që adreson pabarazitë dhe pengesat që lidhen me rolet gjinore dhe implikimet që ato kanë për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, e që janë të rëndësishme për zbatimin e projektit.

Intervistat gjysmë të strukturuar me aktet kryesor në nivel komunal

Hulumtimi është realizuar gjatë muajve maj-qershor 2020, duke filluar me intervistat ballë për ballë duke përdorur pyetësorë gjysmë të strukturuar në nivelin komunal me përfaqësuesit e Drejtorisë Komunale të Bujqësisë dhe Zyrtarëve për Barazi Gjinore në dy komuna: Lipjan dhe Vushtri.

Intervistat u realizuan gjithashtu me përfaqësuesit e organizatave lokale që veprojnë në këto dy komuna, dhe përfaqësues të sektorit privat që operojnë në sektorin e bujqësisë. Intervistat u strukturuan rreth 10 deri në 15 pyetjeve, varësisht nga institucioni apo organizata. Kohëzgjatja e intervistave ishte e ndryshme, duke shkuar nga 40 deri në 60 minuta.

Anketa familjare

Procesi i përzgjedhjes së familjeve që do të marrin pjesë në anketim është zhvilluar në konsultim të ngushtë me IADK dhe Drejtorinë Komunale të Bujqësisë brenda secilës komunë përkatëse, duke marrë parasysh karakteristikat e familjes, pjesëmarrjen, qasjen dhe kontrollin mbi resurse, ndarjen e punës dhe rolet e grave dhe burrave në bujqësi, si dhe vendimmarrjen në lidhje me aktivitetet bujqësore.

Pyetjet e hulumtimit në gjuhën shqipe janë përkthyer dhe përshtatur nga konsulentja (shiko Shtojcën 2 për pyetësin e anketës). Një mostër e rastësishme e shtresuar është përzgjedhur nga listat e familjeve të fshatrave të siguruar nga IADK dhe drejtoritë e bujqësisë në të dy komunat.

Lista e familjeve është modifikuar më vonë si rezultat i takimeve me anëtarët e familjeve në fshatra. Mostra është stratifikuar (shtresuar) për t'u siguruar që studimi të përfshijë familjet që zotërojnë tokë bujqësore dhe merren me aktivitete bujqësore. Një mostër e shtresuar prej 50 gra është përzgjedhur nga listat e përfituesve të projektit të siguruar nga IADK, dhe drejtoritë e bujqësisë. Pyetësorët janë kodifikuar në mënyrë numerike për të siguruar privatësinë. Të dhënat sasiore nga anketa janë koduar dhe analizuar në programin SPSS (Paketa Statistikore për Shkencat Sociale).

Diskutimet në fokus grupe

Pas anketës familjare, dy fokus grupe janë mbajtur në dy komunat, një në Lipjan e përbërë nga gra dhe të rinjë që merren me aktivitete bujqësore, dhe një në Vushtrri. Në total ishin katër pyetje kryesore të hapura. Pas analizës paraprake të anketës dhe intervistave me akterët kyq komunal, diskutimet në fokus grupe janë përdorur për të nxjerrë informacione shtesë rreth roleve të grave dhe të rinjve në aktivitetet bujqësore.

Metodologjia e fokus grupit është orientuar nga pyetjet e anketës familjare dhe qëllimi ishte krahasimi i të dhënave sasiore me ato cilësore. Diskutimet e fokus grupit ofruan informacion të vlefshëm për rolin e grave dhe të rinjve në aktivitetet që lidhen me bujqësinë, si dhe mundësitë dhe sfidat.

Punëtorja me palët e interesit

Me qëllim që të validohen të dhënat e nxjerra nga tereni, në fund të gushtit është mbajtur një punëtori me palët e interesit. Kjo punëtori është përdorur si një mënyrë efektive për të diskutuar gjetjet dhe validimin e tyre.

Profili i komunave

Informacioni për profilet e komunave është marrë nga botimet e OSBE-së si një përmbledhje e të dhënave nga burime të ndryshme për t'u përdorur në këtë analizë.

Komuna e Lipjanit. Komuna e Lipjanit gjendet në Kosovën qendrore. Ajo mbulon një sipërfaqe prej afërsisht 422 km² dhe përfshin qytetin e Lipjanit me 62 fshatra. Sipas Regjistrimit të Popullsisë të Kosovës të vitit 2011, popullsia e përgjithshme është 57,605. Ekonomia e komunës Lipjanit kryesisht bazohet në bujqësi dhe biznese të vogla tregtare. Ka afërsisht 2,110 biznese të regjistruara private që veprojnë në komunë. Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e njerëzve të punësuar në sektorin privat (burimi: drejtoria komunale e zhvillimit ekonomik) dhe ata që punojnë në bujqësi.

Komuna e Vushtrrisë. Komuna e Vushtrrisë është e vendosur në veri-perëndim të Kosovës. Ai mbulon një sipërfaqe prej afërsisht 344 km² dhe përfshin qytetin Vushtri me 64 fshatra. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Strehimit të Kosovës në 2011, popullsia e përgjithshme është 69,870. Ekonomia e komunës së Vushtrrisë kryesisht bazohet në bujqësi, biznese të vogla tregtie dhe industri të përpunimit të drurit. Ka afërsisht 3,000 biznese të regjistruara private që operojnë në bashki. Numri i llogaritur i personave të punësuar në sektorin privat është 6,000 (burimi: qendra komunale e regjistrimit të biznesit), megjithatë, nuk ka statistikë për numrin e njerëzve që punojnë në sektorin bujqësor.

Të dhënat e përgjithshme të pjesëmarrësve në anketën familjare

Në fillim të intervistave, është ofruar një hyrje lidhur me qëllimin e hulumtimit duke iu shpjeguar pjesëmarrësve se anketa ka për qëllim që të merrë më shumë informata rreth sektorit të bujqësisë në komunitetin e tyre dhe ndarjen gjinore të punëve në familje. Pyetësi është përpiluar që të jetë lehtë i kuptueshëm. Nga 50 të anketuar, 48 janë gra dhe dy burra. Moshë mestarare e të anketuarve është 46 vjeç; pjesëmarrësja më e re ishte 20 vjeç dhe ajo më e moshuara ishte 66 vjeç.

Shumica e tyre ishin të martuar/a (35), beqare (9) dhe të ve (6). Duke pasur parasysh që vetëm dy të anketuar janë meshkuj, analiza do të përqendrohet kryesisht tek gratë, pasi krahasimi mes të dyve është i pamundur (duke pasur parasysh numrin e vogël të të anketuarve meshkuj). Në lidhje me statusin e tyre të punësimit, shumica e tyre ishin të papunë – duke mos kërkuar punë (33), të papunë dhe duke kërkuar punë (10), të punësuar (3), dhe të vetëpunësuar (4). Shumica e të anketuarve ishin me shkollë fillore (25), shkollë të mesme (17), universitet (2), pa arsim (1) dhe shkollim 3-5 vjeç (5) Numri mesatar i anëtarëve të familjes ishte 6.14 anëtarë për familje.

Të gjeturat e hulumtimit

Informacioni i dhënë në këtë pjesë paraqet një përmbledhje të përgjithshme të gjetjeve nga dy komunat. Informacione më të hollësishme për secilën komunë do të ofrohen përgjatë pjesëve vijuese të raportit.

Rishikimi i dokumenteve të projektit

Rishikimi i dokumenteve strategjike të projektit tregon se perspektiva gjinore është e integruar në mënyrë sistematike përgjatë dokumenteve të projektit. Qasja strategjike, objektivat dhe intervenimet janë të ndjeshme në aspektin gjuhësor; në kuptimin që dimensionin gjinor ka qenë sistematikisht i përfshirë në zhvillimin e aktiviteteve të projektit, monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të tyre.

Për të siguruar një plan afatgjatë, gjithëpërfshirës të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&E), projekti duhet të vazhdojë të integrojë perspektivën, duke siguruar që planet e M&E dhe të dhënat gjinore janë të besueshme dhe lehtësisht të arritshme, dhe të ndërtojnë aftësinë e partnerëve për të kuptuar dhe mbledhur të dhëna mbi indikatorët e ndjeshëm gjinor. Dokumentet e projektit tregojnë se zbatimi i projektit kërkon metoda të ndryshme të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, që është parakusht për një sistem gjithëpërfshirës të monitorimit dhe vlerësimit.

Intervistat me akterët kyq komunal


Në të dy komunat, nuk ka të dhëna të ndara në bazë të gjinisë. Edhe pse raportohet për mungesë të kohës dhe resurseve njerëzore për të bërë këtë, ka mungesë edhe të ndërjegjësimit gjinor tek stafi për të mbledhur dhe mirëmbajtur të dhënat.

Komunat kanë marrë masa afirmative për të inkurajuar gratë aplikuese për grante dhe skema të tjera mbështetëse. Për shembull, Drejtoria e Bujqësisë në komunën e Vushtrrisë vazhdon të aplikoj këto masa, duke shtuar dhjetë pikë shtesë për secilën grua aplikuese.

Në mënyrë të ngjashme, Drejtoria e Bujqësisë në Komunën e Lipjanit, gjatë periudhës 2016-2019 ka aplikuar masa afirmative për të rritur numrin e grave aplikuese, me tre pikë shtesë. Në vitin 2020, kjo masë u pezullua, me dyshimet e mbështetura se gratë janë përdorur vetëm për të përfituar grantet, por në të vërtetë nuk kanë qenë të angazhuar në bujqësi.

Njëjtë, komuna e Vushtrrisë ka aplikuar masa afirmative për të ndihmuar gratë aplikuese të marrin pikë shtesë për grante dhe skema të tjera mbështetëse. Figura më poshtë tregon numrin e përfituesve në katër vitet e fundit, të ndarë sipas gjinisë. Siç është paraqitur, numri i grave përfituese është i vogël, megjithëse ato inkurajohen dhe përkrahen me pikë shtesë në procesin e përzgjedhjes.

Figura 1. Shpërndarja e granteve, në bazë të gjinisë



Numri i vogël i grave përfituese mund të shpjegohet me angazhimin e ulët të grave në proceset e vendimmarrjes në familje, mungesa e pronësisë së tokës dhe mungesa e informacionit për mundësi të gjenerimit të të ardhurave.

Në nivelin institucional, bashkëpunimi brenda aktorëve kryesor në sektorin e bujqësisë është i pamjaftueshëm, veçanërisht në integrimin e çështjeve gjinore në bujqësi. Për më shumë, të dy institucionet mendojnë se ky koordinim është i panevojshëm, duke pasur parasysh se drejtoria punon me të gjithë, dhe nuk diskriminon në bazë të gjinisë. Zyrtaret për Barazi Gjinore zakonisht nuk marrin pjesë dhe as nuk konsultohen në hartimin e strategjive lokale dhe planeve të veprimit në lidhje me bujqësinë dhe si i tillë procesi i integritit gjinor në bujqësi në të dy komunat mbetet i marginalizuar. Ka nevojë për përmirësim në zingjirin e bashkëpunimit në nivel komunal, duke marrë parasysh edhe faktin që përfaqësues të grave, qoftë nga organizatat joqeveritare apo grupet joformale të grave nuk ftohen në grupet punuese apo gjatë procesit të alokimit të mjeteve për grante.

Gjetjet nga intervistat me aktorët kyq institucional të nivelit lokal tregojnë se interesimi i të rinjve për të punuar në bujqësi është shumë i ulët. Shumica e të rinjve aspirojnë migracionin. Këto gjetje u konfirmuan edhe përmes anketës familjare. Me qëllim të promovimit të punës bujqësore mes të rinjve, Shkolla e Mesme Profesionale e Bujqësisë në Lipjan (për të rinjë dhe të rritur) ka aplikuar herë pas here (me mbështetjen e Komunës - Drejtoria e Arsimit) një skemë bursash, e cila ka motivuar vajzat e reja që të studiojnë për bujqësi. Sidoqoftë, kjo skemë e bursave aktualisht nuk është aktive. Aktualisht, ka 30% të studenteve femra, dhe 70% të studentëve meshkuj të regjistruar në shkollën e mesme, ndërsa në shkollën e mesme për të rritur (pas moshës 18 vjeç), 60% janë studente femra, dhe 40% janë meshkuj.


Të gjeturat nga anketa familjare

1. Qasja dhe kontrolli ndaj resurseve

Të gjithë të anketuarit në anketën familjare kanë një tokë bujqësore. Toka zakonisht është në emër të burrave të moshuar të familjes, disa prej të cilëve kanë vdekur. Grave zakonisht u mungon toka bujqësore në emër të tyre, për shkak të pengesave sociale dhe kulturore, duke l përjashtuar kështu ato nga e drejta e tyre për trashëgimi. Nga numri i përgjithshëm vetëm katër (4) prej tyre kanë tokë në emrin e tyre; prej të cilave dy prej tyre janë të veja.

Drejtoritë Komunale të Bujqësisë në dy komuna nuk kanë shifra të sakta për numrin e grave pronare të tokave. Për shkak të situatës së krijuar me pandemi, në kohën e vizitave në terren, shumica e institucioneve nuk ishin plotësisht funksionale dhe punonin me staf esencial, kështu që nxjerrja e këtyre të dhënave kërkonte bashkëpunim me Zyrën Kadastrale Komunale, e cila nuk ishte e mundur në kohën kur janë realizuar vizitat në terren.

Figure 2. Pronësia e tokës bujqësore



Shumica e familjeve punojnë në aktivitete që lidhen me bujqësinë (86.3%), ku 22% e grave raportuan se punojnë vetëm në bujqësi, ndërsa rreth 50% e tyre punojnë me burrat e tyre. Gjatë kulmit të sesionit, zakonisht të gjithë anëtarët e familjes punojnë dhe ndihmojnë, e veçanërisht familjet që shesin produktet e tyre bujqësore.

Kur u pyetën nëse fëmijët apo të rinjtë ndihmojnë, shumica e të anketuarave raportuan se i angazhojnë ata gjatë sezoneve, zakonisht në përfundimin e një pune që nuk kërkon forcë të madhe fizike. Duke qenë se shumica e grave të anketuara jetojnë gjithashtu me familjet e burrit, të gjithë anëtarët e familjes angazhohen në bujqësi sa herë që është parë e nevojshme.

Vlen të theksohet se gratë që janë përfituese të serrave nga IADK brenda këtij projekti janë të angazhuara në mënyrë aktive në punën bujqësore, dhe ndjeheshin personalisht përgjegjëse për zhvillimin e serrës dhe suksesin e saj. Përafërsisht 40% e të anketuarve përdorin produktet bujqësore vetëm për konsum familjar, ndërsa ata që janë përfitues të serrave presin të shesin produktet në fund të sezonit.

Megjithëse jo të gjitha familjet shesin produktet e tyre, mirëpo në rastet kur shesin, janë zakonisht burrat e familjes ata që janë përgjegjës për shitjen dhe negocimin e çmimit. Kjo për shkak se ata priren të kenë më shumë njohuri për tregun, kanë më shumë rrjetëzim dhe prandaj konsiderohen si më kompetentë në këtë drejtim. Vetëm tri gra raportuan që merren me shitjen dhe negocimin e çmimit. Produktet zakonisht shiten në tregun lokal ose përmes ndërmjetësuesit. Ndonjëherë, produktet, sidomos ato të qumshtit mbledhen shtëpi më shtëpi.

Ekzistojnë disa sfida me të cilat përballen familjet që shesin produktet e tyre; 1) Ndryshimi i shpeshtë i çmimeve që e bën aktivitetin e tyre bujqësor të paqëndrueshëm; 2) Çmimi i ulët që shiten këto produkte - gjë që shpesh ndodh përmes ndërmjetësuesit ose kur kompania i merr produktet direkt në shtëpitë e tyre, dhe 3) Mungesa e një tregu të qëndrueshëm, i cili u garanton atyre që produktet e tyre do të shiten në vazhdimësi dhe kanë treg të qëndrueshëm

Në përgjithësi, familjet marrin çmime të ulëta për produktet e tyre dhe kanë shumë pak fuqi të marketingut. Çështjet me paqëndrueshmërinë e çmimeve, normat e larta të interesit, mungesa e kapitalit dhe mungesa e koordinimit midis fermerëve u përmendën nga të anketuarat si probleme. Janë disa problem në lidhje me shërbimet e zgjerimit të shërbimeve. Së pari, trajnimet dhe mundësitë e ndryshme në bujqësi arrijnë te një numër i kufizuar i prodhuesve, dhe së dyti, shërbimet përqëndrohen kryesisht tek prodhuesit meshkuj dhe me të ardhura të mesme, duke lënë kështu jashtë familjet e varfëra.

Shumica e të anketuarve nuk kishin biznes bujqësor. Nga një numër i përgjithshëm i të anketuarve, vetëm shtatë prej tyre kishin në pronësi biznes, nga të cilët tre ishin në pronësi të grave. Nga tre gra që zotëronin biznese, njëra kishte serrë të madhe e cila mbështetej nga MBPZHR, njëra kishte fermë me bagëti (mbështetur gjithashtu nga MBPZHR), dhe njëra kishte një biznes të vogël të bletarisë (mbështetur nga një OJQ gjermane). Duhet theksuar se të dy gratë kanë trashëguar tokë nga vjehrritë e tyre, dhe kjo i ka ndihmuar ato të zhvillojnë biznesin. Bizneset e mbetura në pronësi të burrave ishin me grurë, misër dhe patate.

Në lidhje me sfidat dhe pengesat me të cilat përballen gratë për të hapur dhe/ose mbajtur biznesin, shumica e të anketuarve raportuan se mbështetja e pamjaftueshme nga strukturat qeveritare, si në nivelin qendror dhe atë lokal (42%), e ndjekur nga mungesa e informacionit (22%), mungesa e tokës (18%), janë disa prej sfidave që e bën shumë të vështirë hapjen e një biznesi nga ana e grave dhe veçanërisht mirëmbajtjen e tij.

1.1 Huazimi i mjeteve dhe kredisë bankare

Pjesa më e madhe e të anketuarave nuk e shohin huazimin e parave nga të afërmit ose huanë nga bankat si një opsion që duhet konsideruar. Kjo për shkak të frikës se nuk mund të kthejnë paratë mbrapa, pasi shumica dërrmuese e tyre nuk kanë të ardhura të rregullta, janë të papuna dhe nuk kanë sistemin e nevojshëm mbështetës për t'u përballur me rrezikun. Disa prej familjeve madje ishin në skemën e ndihmës sociale, një numër i konsiderueshëm i tyre kishin anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara për t'u kujdesur dhe financat e tyre ishin ndikuar shumë nga pandemia.

Në përgjithësi, gratë në Kosovë nuk trashëgojnë pronë (për shkak të normave sociale që i anashkalojnë ato). Duke qenë se ata nuk kanë pronë në emrin e tyre, sistemi i tyre i mbështetjes sociale është gjithashtu i dobët; që do të thotë se edhe të afërmit e familjes hezitojnë t'u japin hua para grave, ndryshe nga burrat që marrin para më lehtë nga anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë.

Nga numri i përgjithshëm i familjeve, vetëm katër (4) prej tyre kanë marrë hua nga bankat, nga të cilat dy prej tyre nga banka e zhvillimit rural. Sidoqoftë, një nga shqetësimet e ngritura prej tyre është se edhe bankat, misioni i të cilave është të ndihmojnë sektorin e bujqësisë kanë norma të larta interesi që janë jo të përshtatshme dhe të ppapërballueshme për familjet e varfra. Përparësia e vetme (marrja e kredive nga këto banka) është se ato kanë kritere më pak të rrepta, nuk kërkojnë kolateral dhe janë më të qasshme nga gratë. Kjo sepse gratë zakonisht nuk kualifikohen për të marrë hua nga institucionet financiare që kërkojnë evidencë të disa të ardhurave të rregullta. Shumica e të anketuarve mendojnë se për gratë është edhe më e vështirë të marrin hua (80%), kjo sepse gratë janë më pak të punësuar, nuk posedojnë tokë në emrin e tyre dhe nuk kanë sistemin mbështetës brenda (familjes së ngushtë dhe gjerë) që mund t'i ndihmojë ato të kthejnë paratë. Prandaj, nëse një familje duhet të marrë një kredi ose të marrë hua para nga të afërmit, burrat e familjes e bëjnë zakonisht atë.

Për të adresuar çështjen e interesit të lartë të aplikuar nga bankat komerciale, komuna e Vushtrisë në vitin 2019 ka aplikuar një system subvencionimi për të mbështetur fermerët përfitues të granteve duke mbuluar kostot e interesit banker nëse ata marrin një kredi bankare, me një bankë me të cilën komuna ka marrëveshje. Për shkak të situatës me pandemi në vitin 2020, fondet janë ri-alokuar drejt nevojave emergjente të qytetarëve.

2. Pjesëmarrja

Në përgjithësi, gratë nuk marrin pjesë në trajnime për aktivitete të lidhura me bujqësinë dhe kanë më pak qasje në informacion. Ekzistojnë ende disa kufizime shoqërore në lidhje me pjesëmarrjen e grave në aktivitetet bujqësore, veçanërisht në takime dhe mundësi të vendimmarrjes. Për shkak se gratë mund të kenë fëmijë të vegjël dhe zakonisht janë të mbingarkuara me punët shtëpiake, ato mund të kenë vështirësi të marrin pjesë në takime.

Për më tepër, një numër i tyre kujdesen për anëtarët me aftësi të kufizuara në familje. Gratë e varura nga bujqësia gjithashtu kanë më pak mundësi për të përfituar grante nga niveli qveritar qendror dhe lokal dhe shpesh nuk janë të vetëdijshme për shërbimet qeveritare për gratë e varfra ose mundësitë për mikrokredi.

Shumica e të anketuarve (98%) nuk ishin pjesë e ndonjë organizate bujqësore, shoqate, kooperative apo OJQ-je. Për më tepër, askush prej tyre nuk ishte në dijeni të ndonjë aktiviteti në komunitet apo iniciative brenda fshatit për të trajnuar familjet për të zhvilluar teknika më të mira për punën bujqësore, megjithëse 85% e të anketuarve në studim i konsiderojnë ato si shumë të rëndësishme.

Nëse ka takime të organizuara në nivelin e komunitetit ose fshatit për çështje që lidhen me bujqësinë, shumica e grave raportuan se burri ose një burrë nga familja do të merrë pjesë (60%), sepse konsiderojnë se është më e lehtë për burrat të marrin pjesë, pasi që ata nuk kanë përgjegjësi në kryerjen e punëve të shtëpisë dhe kanë më shumë kohë të lirë.


Pothuajse të gjitha gratë mendojnë se pjesëmarrja e burrave në takime është çështje praktike dhe jo çështje mentaliteti ose kufizimesh me të cilat mund të përballen gratë për të marrë pjesë.

Të gjithë të anketuarit u përgjigjen me "po" në pyetjen "A do të marrin pjesë gratë në takime ku ka burra të pranishëm"? dhe 87% e tyre u përgjigjën "jo të rëndësishme për mua" në pyetjen "A do të preferonit të keni trajnime vetëm për gratë dhe takim"? Për më tepër, gratë nuk e konsiderojnë pjesëmarrjen e tyre në takime si të domosdoshme, përkundrazi ata mendojnë se kushdo që është më i disponueshëm në familje do të marrë pjesë.

Për shkak të çështjeve që lidhen me transport, veçanërisht në fshatrat më të largëta, gratë mendojnë se është më lehtë për burrat të shkojnë në komunë dhe të kërkojnë mbështetje, duke pasur parasysh se ata mund të përdorin mjete tjera të transportit, përveç autobusëve. Në përgjithësi, gratë që mbështeten vetëm në punën bujqësore janë të varfra. Prandaj, edhe nëse familja e tyre ka një makinë, janë burrat që ngasin makinën.

Në anën tjetër, burrat që nuk zotërojnë makina, mund të përdorin edhe mjete të tjera transporti, të ndara me burra të tjerë në fshat, p.sh. minivan. Në përgjithësi, gratë mendojnë se pengesat e grave për pjesëmarrje aktive në sektorin e bujqësisë lidhen me punën fizike.

Figure 3. Barrierat kryesore që pengojnë pjesëmarrjen aktive të grave në bujqësi



3. Ndarja e punës

Më shumë se gjysma e grave të anketuara (56%) raportuan se kalojnë më shumë se tetë (8) orë duke bërë punë që nuk lidhen me bujqësinë, të ndjekura nga 6-8 orë (18%) dhe 3-5 orë (8%). Shumicën e kohës së tyre gratë e kalojnë në pastrim dhe gatim. Sidoqoftë, orët e raportuara nuk ishin vetëm për punët e shtëpisë. Shumica e tyre nuk ishin në gjendje t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje me saktësi - duke e ndarë kohën për punët e shtëpisë nga aktivitetet bujqësore dhe kalojnë nga njëra punë në tjetrën. Shumica e tyre mendojnë se punët shtëpiake

nuk ndikojnë në angazhimin e tyre në bujqësi. Nëse ka më shumë punë në serrë, ata do të punojnë më pak duke bërë punët e shtëpisë dhe anasjelltas.

Megjithëse i vogël në numër, për ato familje që kultivojnë produkte bujqësore jo vetëm për konsum familjar por edhe për shitje, ka një ndarje më të qartë të roleve brenda familjes. Burrat zakonisht kryejnë punë që kërkon forcë fizike dhe janë kryesisht përgjegjës për shitjen e produkteve dhe negociimin e çmimit, duke qenë se konsiderohen se kanë më shumë njohuri në këtë drejtim. Tek familjet që kanë bagëti (edhe pse të pakta në numër), janë burrat ata që zakonisht kujdesen për to (duke siguruar ushqim, pastrim, kujdes shëndetësor), megjithatë mjelja bëhet zakonisht nga gratë.

Në përgjithësi, gratë që punojnë në bujqësi janë të mbingarkuara me punë shtëpiake dhe bujqësore. Përveç punës në bujqësi, ato pastrojnë, gatujnë dhe kujdesen për fëmijët dhe të moshuarit e familjes. Një numër i grave të anketuara në familjet e intervistuar gjatë kësaj periudhe po kujdeseshin edhe për personat me aftësi të kufizuara në familje. Megjithatë, të gjitha gratë treguan gatishmërinë e tyre për të punuar edhe më shumë nëse kjo do të përmirësonte situatën e familjes së tyre, veçanërisht atë të fëmijëve të tyre.

Pavarësisht ngarkesave të mëdha të punës, shumë prej tyre mendojnë se nuk po bënin sa duhet për familjen pasi që nuk kanë një punë me pagë mujore. Ato mendojnë se kontributi i tyre është i vogël, dhe se do të kontribuonin më shumë nëse do të ishin në gjendje të zgjerojnë punën e tyre në bujqësi dhe të shesin produktet.

Një çështje tjetër që vlen të theksohet është se pavarësisht interesit të grave për bujqësi, ekziston një përshtypje e përgjithshme që puna në bujqësi nuk është diçka për t'u aspiruar dhe se vetëm kur një familje nuk ka mjete të tjera për të mbijetuar synon të punojë në bujqësi. Bujqësia shihet më shumë si një mënyrë për të mbijetuar. Kjo pjesërisht vjen nga perceptimi i përgjithshëm se puna bujqësore nuk paguhet mirë, investimet nuk janë të sigurta dhe ka një mungesë stabiliteti financiar, pasi rezultatet varen plotësisht nga kushtet klimatike dhe dinamika e tregut.

Pavarësisht nga karakteristikat e familjes, ndarja e bazuar në gjini e punës në zonat rurale do të thotë që gratë janë pothuajse komplet përgjegjëse për kujdesin familjar dhe punët e shtëpisë. Pavarësisht se sa orë mund të vendosin gratë në prodhimin ose përpunimin bujqësor, ato mbajnë përgjegjësinë për fëmijët dhe të moshuarit, për pastrimin dhe gatimin. Intervistat nuk treguan ndonjë ndryshim të roleve të tilla sociale, megjithëse gratë konfirmojnë që përfshirja e burrave për punët e shtëpisë nuk është aq e ngurtë sa më parë. Në përgjithësi, gratë paraqitën qëndrime mjaft tolerante ndaj barazisë gjinore në lidhje me rolet dhe mundësitë për aktivitete bujqësore dhe ekonomike.

Në lidhje me kohën e shfrytëzuar, puna e grave zakonisht fillon nga ora 6 deri në 7 të mëngjesit. Mund të thuhet se ditët e punës së grave mund të jenë deri në pesë orë më shumë se ato të burrave. Kur u pyetën se sa orë punojnë në punët e shtëpisë që nuk kanë të bëjnë me bujqësinë, shumica e tyre thanë 'gjithë ditën', nga koha kur zgjohen, e cila është rreth 6-7, veçanërisht për ata që kanë bagëti deri në 20: 00.


Sidoqoftë, numri i familjeve që kanë bagëti është i vogël, gjë që e bën të pamundur përgjithësimin. Sidoqoftë, është e qartë se pabarazia midis ngarkesave të punës së burrave dhe grave ilustron se duhet të bëhen përpjekje për të dekonstruktuar konstruktet shoqërore të gjinisë dhe për të bindur burrat të ndihmojnë në shtëpi, ose teknologjitë për uljen e punës së shtëpisë duhet të ndahen me gratë.

4. Vendimmarrja në familje

Shumica e të anketuarve (78%) kanë përfituar nga grante që lidhen me bujqësinë, ndërsa 22% e tyre nuk kanë përfituar asnjëherë ndonjë grant. Sidoqoftë, këto grante jo gjithmonë i kanë ndihmuar ata të rrisin aktivitetet e tyre të gjenerimit të të ardhurave në nivele të knaqshme. Në përgjithësi, këto familje kanë përmbushur disa kriterë (të qenit i varfër, të qenurit përfitues të ndihmës së skemës sociale, të kesh një person me aftësi të kufizuara në shtëpi dhe të jesh e ve), edhe pse ka përjashtime.

Në pyetjen 'Cilat mendoni se janë gjërat më të rëndësishme që ju duhen në mënyrë që të rrisni të ardhurat dhe mirëqenien tuaj?', Shumica e të anketuarve i kanë përparësi nevojës për pajisje dhe teknika për të zvogëluar ngarkesën e punës, më saktësisht traktorë të vegjël (kultivatorë) që do të ju ndihmojnë të punojnë brenda serrave, siç paraqitet në Figurën 4.

Figura 4. Cilat gjëra janë të rëndësishme për të ngritur të ardhurat tuaja?



Shumica e tyre kanë ngritur nevojën për një qasje më të lehtë në informacion në lidhje me aktivitetet dhe mundësitë e ndryshme që lidhen me bujqësinë. Në pyetjen se si kanë marrë vesh për grantin, shumica e tyre raportuan se informacionin e kanë marrë nga anëtarët e familjes së gjerë ose nga informatat që zakonisht kanë ardhur nga burrat në familje, pasi që ata kanë qasje më të lehtë në informacion. Kjo tregon se gratë kanë më pak qasje në informacion. Edhe pse disa nga informacionet mund të sigurohen në mediat sociale, gratë, veçanërisht ato mbi moshën 50 vjeç nuk kanë qasje, ndërsa për ato që kanë qasje mund të mos dinë se ku dhe si ta kërkojnë këtë informacion (cilën faqe ta ndjekin për lajme rreth bujqësisë).

Në pyetjen “A ka ndonjë fushë për të cilën ju jeni veçanërisht të interesuar të mësoni për të rritur të ardhurat tuaja?”, shumica e tyre (68%) ishin të interesuar për bletarinë, e ndjekur nga interesimi për të mësuar më shumë rreth produkteve të tjera bujqësore (22 %), dhe përpunimin e perimeve (10%). Interesimi për bletari u hulumtua më tej gjatë intervistave. Disa nga shpjegimet e dhëna nga gratë është se puna në këtë sektor është më e lehtë për gratë pasi nuk kërkon forcë fizike dhe është shumë fitimprurëse.

Sa i përket qasjes në transport, edhe pse një numër i konsiderueshëm i fshatrave ishin mjaft të largëta, transporti nuk shihej problem për përgratë e anketuara, pjesërisht për shkak se ato personalisht nuk kanë hasur situata kur kishin nevojë për transport dhe nuk mund ta përballonin atë. Vetëm katër prej tyre raportuan se mjetet e transportit nuk ishin të përshtatshme për gratë, nuk ishin të përballueshme dhe të sigurta. Sidoqoftë, kur u pyetën nëse ka ndonjë problem që gratë e tjera të udhëtojnë në fshatra të tjera dhe në qytet për aktivitete që lidhen me bujqësinë, shumica e tyre raportuan se shqetësimet e transportit paraqesin një problem për lëvizshmërinë e grave. Kjo është për shkak se nuk ka transport publik të disponueshëm, veçanërisht pas bllokimit për shkak të pandemisë, dhe mjetet e vetme të transportit sigurohen nga furgonë privatë të palicencuar.

Për të përcaktuar se kush merr vendime në lidhje me përgatitjen e buxhetit familjar, shpenzimin e parave, përzgjedhjen e produkteve dhe inputet bujqësore, në shumicën e rasteve të dy bashkëshortët marrin vendimet dhe shumë shpesh përfshihen edhe anëtarët e rritur të tjerë ta familjes. Në familjet më të vogla (ku jetonte vetëm çifti me fëmijë), gratë dhe burrat i merrnin vendimet bashkërisht, ndërsa në rastet kur gruaja ishte e ve, vendimet i merrte e vetëm ose me djemtë e rritur. Në përgjithësi, menaxhimi i financave bëhet bashkërisht. Gratë raportuan se ato janë pjesë e proceseve të vendimmarrjes brenda familjes, por më shpesh kur jetojnë vetëm me burrat dhe fëmijët e tyre. Kur jetojnë me familjen e burrit në të njëjtën shtëpi, mundësitë e vendimmarrjes për gratë zakonisht zvoglohen.

Normat social dhe kulturore rreth divizionit të resurseve

Hulumtimi mblodhi të dhëna mbi vlerat, qëndrimet dhe stereotipat gjinore dominuese, të cilat formësojnë marrëdhëniet gjinore dhe shpjegojnë pse gratë kanë status dhe fuqi vendimmarrëse më të ulët në familje dhe komunitet.

Kur u pyetën “nëse keni burime të kufizuara, a do të investonit tek djemtë apo vajzat e familjes”, shumica e të anketuarve (84%) thanë se do të ishte njëjtë për të dy, ndërsa 16% e tyre raportuan se burimet duhet të shkojnë vetëm te djemtë dhe burrat e familjes. Të njëjtat përgjigje u dhanë kur u pyetën “Kush duhet të trashëgojë pronën brenda familjes dhe pse”?

Shumica e grave (86%) mendojnë se gratë dhe burrat duhet të trashëgojnë pronë njëjtë, dhe vetëm gjashtë prej tyre mendojnë se vetëm anëtarët meshkuj të familjes duhet të trashëgojnë.

Nga ky numër i vogël, tre prej grave ishin të veja, dhe kanë transferuar ose po planifikojnë ta transferojnë tokën në emër të djemve të tyre.

Gjatë dhënjes së përgjigjes në këto dy pyetje shumica e grave treguan ndjeshmëri të lartë për rëndësinë e trashëgimisë dhe dëshirën për të kaluar trashëgiminë edhe tek vajzat e tyre. Atao ishin të shqetësuara për të ardhmen e vajzave nëse nuk do të mund të ju ofronin një shkollim apo nëse nuk do të iu jepej pronë, megjithëse ishin të vetëdijshme se në rrethanat aktuale, dhënia e pasurisë vajzave në fshatra nuk ishte një praktikë dhe është një sfidë më vete. Sidoqoftë, shumica e tyre shprehën dëshirën e tyre për të investuar më shumë në vajzat e tyre duke u ofruar atyre shkollim që ju ndihmojnë të gjejnë punë. Në lidhje me këtë, njëra nga gratë u shpreh se *"Për burrat është më lehtë të gjejnë punë në Kosovë, të mbijetojnë dhe të zhvillohen. Sidoqoftë, për gratë është më e vështirë. Ato nuk mund të bëjnë çfarëdo pune. Duhet të jetë një punë e mirë. Prandaj, është më e rëndësishme që vajzat të arsimohen, pasi djemtë do të gjejnë rrugën e tyre për të mbijetuar"*. I njëjti shpjegim u dha nga shumica e grave të anketuara, pavarësisht nga karakteristikat e tyre të familjes.

Kur jemi te stereotipat gjinore dhe normat sociale, në pyetjen nëse burrat duhet të marrin pjesë më shumë dhe në mënyrë të barabartë në rritjen e fëmijëve dhe punët e shtëpisë me gratë, shumica e grave (82%) raportuan se edhe pse nuk është diçka e keqe që burrat të angazhohen në punët e shtëpisë, ato preferojnë që burrat e tyre të punojnë jashtë shtëpisë sesa të ndihmojnë në punët e shtëpisë. Ato mendojnë se kohët kanë ndryshuar dhe roli i burrave nuk janë aq i ngurtë kur bëhet fjalë për punët e shtëpisë. Sidoqoftë, megjithëse nuk shprehen me zë të lartë, shumica e grave nuk mendojnë se është e përshtatshme që burrat të bëjnë punë shtëpie. Për më shumë, ato asnjëherë nuk kanë angazhuar djemtë e tyre në punët e shtëpisë.

Njësoj si më sipër, në pyetjen mbi pronësinë, përgjigjet mund të jenë të njëanshme dhe mund të ndikohen nga e ashtuquajtura "dëshirueshmëria sociale" për të dhënë përgjigjen e duhur dhe më moderne, për të mos u paragjykuar.

Duke qenë se të drejtat pronësore të grave dhe përgjegjësia e burrave ndaj rritjes së fëmijëve dhe punët e shtëpisë janë koncepte relativisht moderne në Kosovë, të diskutuara vetëm në vitet e fundit në mjediset urbane, përgjigjet e dhëna në këtë analizë nuk duhet të jenë arsye për përgjithësimin e mendimit të grave për këto çështje. Nevojitet një analizë e thelluar për të kuptuar më tej këto dinamika.

Sipas pjesëmarrësve në anketë, pengesat kryesore për gratë për të pasur një tokë bujqësore janë mentaliteti dhe traditat e vjetra që preferojnë djemtë mbi vajzat, veçanërisht në dhënie e trashëgimisë. Kjo shpjegohet me traditën që djemtë martohen dhe qëndrojnë në shtëpi, ndihmojnë prindërit dhe jetojnë me ta, ndërsa vajzat martohen, shkojnë jashtë familjes së origjinës, krijojnë jetën e tyre dhe nuk janë një faktor mbështetës për prindërit kur është e nevojshme. Për fund, në pyetjen "Kush duhet të thotë fjalën e fundit në familje", gratë zakonisht mendojnë se të rriturit duhet të kenë fjalën e fundit, mirëpo hezituan të japin një përgjigje më të qartë lidhur me këtë. Sidoqoftë, ato zakonisht mbështeten tek bashkëshortët dhe burrat e tjerë të familjes për të marrë vendimet, e sidomos kur është fjala për vendimet më të vështira për familjen.

Impakti i pandemisë në situatën ekonomike të familjeve

Në përgjithësi, familjet janë ndikuar shumë nga mbyllja gjatë pandemisë. Një numër i konsiderueshëm i burrave në familjet e vizituara kanë humbur punën. Duke qenë se ata kanë

punuar në sektorin informal të ekonomisë, nuk kanë pasur të drejtë për disa nga masat mbështetëse të qeverisë. Një total 74% e të anketuarve raportuan humbje që erdhën nga bllokimi në pandemi, në forma të ndryshme. Ndërsa disa prej tyre humbën punën, disa nuk ishin në gjendje të shesin produktet e tyre (një familje nuk ishte në gjendje të shiste patate dhe pjesa tjetër e familjeve spinaq). Megjithëse humbjet në shitje nuk u konsideruan tepër të larta (përveç familjes që punon me patate), ajo gjithsesi preku shumicën e familjeve, duke qenë se edhe shumica të vogla të të ardhurave lehtësojnë situatën e vështirë ekonomike të këtyre familjeve.

Të gjeturat e diskutimeve prej focus grupeve

Diskutimi në fokus grupe u përqendruan në katër tema kryesore, njejtë si anketa. Sidoqoftë, pyetjet e focus grupeve janë përqendruar më shumë në gjetjen e perspektivës së të rinjve duke qenë se numri i të rinjve që morën pjesë në anketë ishte i vogël.

Diskutimet zbuluan dhe konfirmuan disa nga të dhënat e mbledhura nga anketa kur bëhet fjalë për interesin dhe angazhimin e të rinjve në bujqësi. Në përgjithësi, të rinjtë e konsiderojnë bujqësinë si një punë jo shumë të denjë. Ata priren të shmangin punën në bujqësi dhe poashtu edhe familjet nuk i inkurajojnë ata të punojnë në këtë sektor. Ky refuzim vjen kryesisht nga mendimi se bujqësia është punë e rëndë fizike që nuk ka perspektivë. Ka përçmim rreth punës bujqësore mes të rinjve, dhe të rinjtë zakonisht nuk ndihen rehat të shoqërohen me bujqësi. Për më tepër, ekziston një hezitim nga ana e familjeve për të angazhuar të rinjtë e tyre në bujqësi, pasi ata mendojnë se po i lënë ata pa 'perspektivë'. Një arsye tjetër për mungesën e angazhimit është se shumica e të rinjve në të dy komunat aspirojnë migrimin.

Disa nga rekomandimet për rritjen e interesimit të të rinjve për bujqësinë të ofruara në këto diskutime janë se së pari ka nevojë për të punuar në ndryshimin e mendësisë dhe perceptimit përreth bujqësisë. Në këtë drejtim, të rinjtë duhet të mbështeten që të shikojnë bujqësinë si një punë të denjë, si çdo profesion tjetër. Kjo mund të arrihet përmes fushatave promovuese në nivel kombëtar dhe lokal, dhe ndërgjegjësimin në nivelin e komunitetit. Për më tepër, përpjekjet për të ndryshuar mënyrën e të menduarit se si të rinjtë mendojnë për bujqësinë duhet të fillojë në shkollat e mesme, ku bujqësia paraqitet si një mënyrë e mirë për të siguruar jetesën.

Një mënyrë tjetër për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në bujqësi është përmes granteve dhe subvencioneve, trajnimeve të përshtatura për një kulturë të caktuar të perimeve dhe sigurimit të mjeteve - veçanërisht për gratë për të zvogëluar ngarkesën fizike të punës. Për më tepër, investimet duhet të përqendrohen në shkollat profesionale dhe duhet të prezantohen modele pozitive për të inkurajuar të rinjtë të regjistrohen në këto shkolla, gjë që u siguron atyre mjetet për të pasur një qasje më të lehtë në tregun e punës.

Një pengesë tjetër për të rinjtë dhe gratë për të marrë një grant është se zakonisht nuk kanë në pronësi tokë, duke pasur parasysh që disa thirrje për grante kërkojnë që një aplikant të ketë tokë në pronësi. Kjo penalizon sidomos gratë që dëshirojnë të vazhdojnë punën e tyre në bujqësi.

E ashtuquajtura "shuma e pjesëmarrjes" - ku aplikantët ndonjëherë, varësisht nga thirrja e grantit, qoftë nga institucionet qendrore dhe lokale ose donatorët, duhet të marrin pjesë me një shumë të caktuar parash (afërsisht midis 150 - 200 euro) është një sfidë tjetër që duhet të adresohet. Shpesh gratë, veçanërisht nga familjet e varfra nuk e kanë këtë shumë, dhe kjo mund të jetë një nga arsyet që ato penalizohen që nga fillimi i procesit. Në përgjithësi, pjesëmarrësit në focus grupe mendojnë se duhet të sigurohej një trajnim më i përshtatur për

gratë që punojnë ose janë të interesuara të punojnë në bujqësi, duke u ofruar atyre aftësi në një kulturë të caktuar bujqësore. Për më tepër, shkëmbimi i informacionit me gratë për mundësi të ndryshme duhet të jetë shumëdimensional. Në shumë raste gratë që dëshirojnë të punojnë në bujqësi ose të zgjerojnë punën e tyre nuk janë të njohura me mundësitë e ofruara.

Qasja në treg dhe ndryshimi i shpeshtë i çmimeve për produktet që ato punojnë është një sfidë tjetër e cila është diksutuar në focus grupe, të cilat gjithashtu u gjetën në anketën familjare. Megjithëse gratë që kanë burra në familje kanë qasje më të lehtë në treg, duke pasur parasysh që burrat e tyre shumicën e kohës i shesin ato, megjithatë, për ato që janë të veja kjo bëhet një luftë e vërtetë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që u përmend gjatë kësaj kohe është se gratë kanë vështirësi në marrjen e kredive. Kjo sepse ata nuk punojnë dhe për këtë arsye nuk kanë mjete për të kthyer paratë, dhe sepse u mungon pronësia e tokës. Një sfidë tjetër me kredinë bankare është interesi i lartë i paraqitur ndaj tyre. Edhe bankat e orientuara nga bujqësia kanë interes të lartë, njësoj si bankat tregtare, vetëm se ato kanë kritere më të lehta për t'u përmbushur.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

Kjo analizë gjinore ka treguar se gratë luajnë një rol të rëndësishëm dhe vendimtar në zhvillimin e bujqësisë. Natyra dhe shkalla e përfshirjes së grave në bujqësi, pa dyshim, ndryshon nga një familje në familje. Edhe brenda së njëjtës komunë, përfshirja e tyre ndryshon shumë midis nën-zonave të ndryshme, dhe karakteristikave familjare. Sidoqoftë, pavarësisht nga këto variacione, vështirë se ka ndonjë aktivitet në prodhimin bujqësor, përveç plugimit në të cilin gratë nuk janë të përfshira në mënyrë aktive. Njohja e rolit të tyre thelbësor në bujqësi nuk duhet të nënvleftësojë faktin që gratë vazhdojnë të merren pothuajse të vetme me punët e shtëpisë, rritjen e fëmijëve dhe kujdesin ndaj të moshuarëve dhe në disa raste edhe për anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara.

Gratë mund të luajnë rol shumë të rëndësishëm si në zhvillimin rural si edhe në zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e bujqësisë, sidomos gratë, mirëqenia ekonomike e të cilave varet nga aktivitetet bujqësore. Pavarësisht nga rëndësia e tyre për prodhimin bujqësor, gratë përballen me disa pengesa. Është e rëndësishme që grave më të varfra rurale t'u ofrohen më shumë lehtësira për tokë, shërbime bujqësore dhe shtrirje të bagëtisë. Për më tepër, gratë duhet të përfshihen në organet vendimmarrëse që kanë potencialin për të futur ndryshime strukturore.

Projekti ka ofruar trajnime dhe ka mbështetur përfituesit e serrave gjatë gjithë procesit, ndërsa vazhdimisht iu ka ofruar atyre këshilla të drejtpërdrejta në lidhje me proceset e kultivimit për secilën kulturë bujqësore për fermerët. Projekti u ka siguruar grave një bazë solide për rritje të mëtejshme dhe me qëllim ka shpërndarë serrat për një numër më të madh të grave, duke forcuar kështu rolin e tyre dhe vendimmarrjen në ekonomitë e tyre familjare. Sidoqoftë, nevojitet mbështetje e mëtejshme për të zhvilluar ekonomitë familjare dhe për të rritur produktivitetin, duke u mundësuar atyre hyrjen në treg.

Ndërsa sa i përket angazhimit të të rinjve në bujqësi, deri më tani drejtoritë komunale të bujqësisë nuk kanë ofruar ndonjë program të dizajnuar, të veçantë, për të angazhuar të rinjtë në bujqësi. Për më tepër, asnjë nga Zyrat Komunale të Punësimit nuk ofron ndonjë trajnim të përshtatur në bujqësi. Të rinjtë që mbarojnë universitetin nuk kanë përvojë praktike, prandaj IADK krijon mundësi që të rinjtë të zbatojnë njohuritë e tyre teorike në praktikë përmes projekteve të ndryshme

1) Përkrahja e grave në bujqësi

Programet e synuara për gratë duhet të caktohen duke pasur në mendje profilin e aktivitetit dhe nevojat e grave në bujqësi. Informacionet e ofruara duhet të paraqitet në atë mënyrë që të jenë të arritshme për të gjitha gratë, pavarësisht nga niveli i arsimimit, dhe të jenë të kuptueshme. Për shkak se gratë mbajnë barrën e punëve të shtëpisë, për të rritur efikasitetin e programeve, shërbimet duhet të drejtohen tek gratë, duke iu ndihmuar atyre edhe të zvogëlojnë barrën e punës fizike.

Kurdoherë që është e zbatueshme, projekti mund të bashkëpunojë me këshillat e fshatrave dhe të avokojë për pjesëmarrjen e grave në këto mekanizma. Vlen të theksohet se ekipi i projektit ka praktikuar ndarjen e fletëpalosjeve informuese të projektit gjerësisht në fshatra, dhe përmes

arritjes së përfaqësuesve të tij, sidoqoftë, siç raportohet nga ekipet e projektit ndodh që informacioni të mos shpërndahet gjërësisht në fshat, por të mbahet për vete.

1 [Rritja e qasjes dhe kontrollit në resurse](#)

1.1 [Përkrahja e grave për të rritur qasjen në pronësi dhe financa](#)

Projekti mund të mbështesë gratë me qasje më të madhe në tokë, financa dhe prodhim, e cila është thelbësore për të mbyllur hendekun e produktivitetit midis burrave dhe grave. Në bashkëpunim me drejtoritë e bujqësisë, projekti gjithashtu mund të avokojë tek bankat e zhvillimit rural për "paketa kredie" që kanë norma më të ulëta interesi dhe kushte më të mira për gratë sipërmarrëse në bujqësi. Duke qenë se gratë kanë më pak njohuri për mundësitë e ndryshme që ekzistojnë në sektorin e bujqësisë, projekti mund të lehtësojë punën e grupeve joformale të grave për të krijuar asociacione, shoqata apo kooperativa të grave për qasje të lehtë në hua dhe kredi dhe për të mbështetur rrjetëzimin e tyre.

1.2 [Të forcohet bashkëpunimi ekzistues me akterët komunalë dhe akterët e tjerë joqeveritarë që punojnë në bujqësi](#)

Bashkëpunimi midis IADK-së dhe drejtorive të bujqësisë duhet të forcohet. Në këtë drejtim, projekti mund të avokojë tek drejtoritë e bujqësisë për të vazhduar me masa afirmative, duke qenë se Lipjani kohët e fundit ka pezulluar masat, për shkak të dyshimeve për keqpërdorim nga ana e përfituesve. Praktika e diskriminimit pozitiv duhet të vazhdojë duke marrë parasysh veçanërisht kriteret që mund të motivojnë gratë (p.sh. gratë kryefamiljare, gratë që kujdesen për anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara, etj) dhe duhet të marrin në konsideratë mekanizmat e kontrollit që monitorojnë nga afër procesin për t'u siguruar që grantet janë me të vërtetë për gratë.

Për më tepër, projekti mund të mbështesë drejtoritë e bujqësisë për të integruar vazhdimisht çështjet gjinore në bujqësi. Kjo mund të operacionalizohet përmes organizimit të një tryeze të rumbullakët ku aktorët komunalë (përfaqësues të drejtorive, Zyrtëreve për Barazi Gjinore, përfaqësues të organizatave të grave dhe grupeve joformale të grave që punojnë në bujqësi dhe akterë të tjerë kyq) janë të përfshirë në diskutim mbi sfidat dhe mundësitë e grave në bujqësi. Për më tepër, IADK mund të mbështesë Drejtoritë e Bujqësisë dhe Zyrtëreve për Barazi Gjinore të krijojnë një plan të përbashkët veprimi për të integruar çështjet gjinore në bujqësi. Së bashku me Zyrën Kadastrale, projekti mund të avokojë për të lehtësuar qasjen e grave në pronësinë e tokës. Insentiva për bashkëshortët që regjistrojnë tokën në emër të përbashkët duhet të inkurajohen dhe të avokohet për të.

2 [Rritja e pjesëmarrjes së bujqësi](#)

2.1 [Të mbështetet qasja e grave në informacion dhe iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve](#)

IADK mund të mbështesë qasjen e grave në trajnime dhe informacione, duke pasur parasysh se njohuritë mbi teknikat e bujqësisë janë thelbësore për produktivitetin. Kjo nënkupton shtrirjen e shërbimeve të fuqishme të zgjerimit dhe trajnimit bujqësor, të cilat duhet të përshtaten me nevojat dhe sfidat e grave, përmes bashkëpunimit me grupet e grave që punojnë në bujqësi dhe organizata të tjera joqeveritare që punojnë në këtë sektor. Kur është e mundur, inkurajohet

rekrutimi dhe trajnimi i punonjësve gra të shërbimeve në projekt. Gratë mund të ndjehen më mirë për të kontaktuar një punëtore grua për çdo çështje lidhur me serrë, për shembull.

2.2 Të 'hartëzohet' lista e sfidave dhe nevojave të grave që punojnë në bujqësi

Të kuptuarit e nevojave individuale të familjeve në bujqësi është e rëndësishme për të fituar një pasqyrë të plotë se kush ka nevojë për çfarë. IADK përmes projektit mund të krijojë një hartëzim të nevojave për ekonominë familjare dhe gratë që punojnë në bujqësi; d.m.th. cila familje çfarë ka nevojë, dhe të përcaktoj nivelin e ndihmës së nevojshme për secilin përfitues të serrës. Duke pasur parasysh që nevojat dhe sfidat e tyre janë të ndryshme, edhe mbështja ndaj tyre duhet të përshtatet. Për shembull, nga 10 familje që kanë përfituar nga serrat, vetëm dy mund të kenë nevojë për kutivator. Një shembull tjetër mund të jetë që nga 10 përfitues, 3 prej tyre nuk kanë qasje të lehtë në treg; ose sepse ato janë gra kryefamiljare, nuk kanë informacione për mundësitë që ofrohen, ose sepse thjesht kanë nevojë për mbështetjen e projektit për të hyrë në treg (përmes bashkëpunimit të projektit me sektorin privat).

Duke pasur parasysh që nevojat e familjeve janë të ndryshme dhe unike, IADK mund të shohë mundësinë për të zgjeruar fushën e saj të punës ose për ta përshtatur atë me kërkesat e reja nga gratë përfituese të mundshme, dhe të marrë parasysh interesin e grave për bletari.

2.3 Të mbështetet krijimi i shoqatave të grave dhe grupeve të tjera formale dhe joformale

Njejtë si rritja e qasjes dhe kontrollit të grave në resurse, IADK mund të avokoj dhe të përkrahë krijimin e shoqatave të grave që punojnë në aktivitete bujqësore dhe krijimin e një database të unifikuar në nivel komunal. E njehta aplikohet edhe për projektin. Projekti mund të krijojë një databazë të grave që janë të interesuara të punojnë në bujqësi dhe atyre që tashmë janë aktive në këtë fushë.

2.4 Të promovohet qasja e integruar e fermave familjare

Për të siguruar angazhimin aktiv të grave në bujqësi, është e rëndësishme që projekti të promovojë një qasje të integruar të bujqësisë familjare përmes trajnimeve shtesë dhe shërbimeve këshilluese rurale dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e grave. Kjo qasje promovohet gjerësisht nga UN FAO dhe agjenci të tjera të zhvillimit të bujqësisë. Sidoqoftë, mënyra e përdorimit të këtij termi në këtë raport është se ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës (pjesëmarrës), ku gratë janë pjesë e proceseve të vendimmarrjes. Sistemi i integruar i bujqësisë është gjithashtu një sistem i qëndrueshëm i cili përqendrohet në rritjen e produktivitetit të fermave duke rritur diversifikimin, integrimin e burimeve dhe krijimin e lidhjeve me treg.

2.5 Të vazhdohet të promovohet integrimi gjinor në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural

Projekti duhet të promovojë vazhdimisht përfshirjen gjinore në të gjithë sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural duke organizuar dhe lehtësuar punëtorët për palët e interesuara lokale dhe partnerët e programit. Projekti ka kapacitet dhe është në një pozitë të mirë për të promovuar integrimin gjinor dhe ndjeshmërinë gjinore ndaj institucioneve lokale të bujqësisë (siç janë drejtoritë komunale të bujqësisë). Ekziston një mungesë ndërgjegjësimi për rëndësinë e integritit të gjinisë në bujqësi tek akterët institucional komunal.

2.6 Të rriten aftësitë sipërmarrëse, menaxheriale dhe teknike të grave

Projekti duhet të punojë përmes dhe me grupet e grave për të rritur aftësitë e tyre sipërmarrëse, menaxheriale dhe teknike, si dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre të vetëbesimit dhe udhëheqjes, veçanërisht aftësitë e tyre të vetë-efikasitetit. Për më tepër, projekti mund të lehtësojë përfaqësimin e grave në dialogun e planifikimit të zhvillimit të komunitetit dhe proceset e vendimmarrjes dhe t'u sigurojë anëtarëve të komunitetit trajnime për rritjen e ndërgjegjësimin gjinor, të tilla si zhvillimi i shkollave të fermerëve me target gratë, dhe organizimi i vizitave të shkëmbimit të fermerëve.

2.7 Të përmirësohet shpërndarja e informacionit mbi mundësitë e lidhura me bujqësinë

Projekti mund të mbështesë drejtoritë e bujqësisë për të rritur qasjen te gratë rurale që punojnë në bujqësi, përmes ndihmës në krijimin e shoqatave të grave për produktet bujqësore dhe krijimin e rrjetezimit, madje edhe ato virtuale. Projekti duhet të përdorë metoda të ndryshme për të informuar gratë rurale mbi aktivitete të ndryshme për gjenerimin e të ardhurave. Një prej tyre është përdorimi i metodave jo-konvencionale për të njoftuar gratë për aktivitetet e krijimit të të ardhurave. Kjo mund të arrihet përmes sistemit të shpërndarjes së informative “derë më derë” për gratë. Ekziston një besim i përhapur në mesin e grave se të njëjtat gra janë të informuar për mundësi të ndryshme dhe se një numër i madh i grave mbeten të pa informuara për mundësi të ndryshme që ofrohen në sektorin e bujqësisë.

3 Të adresohet ndarja e punës

Ekziston një ndarje e roleve gjinore në familjet e vizituara, e cila mund të thuhet se edhe përfaqëson rolet sociale gjinore brenda familjeve në Kosovë, në përgjithësi, pavarësisht nga përkatësia etnike. Për të zvogëluar ngarkesën e punës së grave në bujqësi, duhet të merrën parasysh mundësinë për të siguruar teknologji të kursimit të punës për gratë që kanë serra (traktorë të vegjël).

Puna me burra dhe djem në trajtimin e çështjeve gjinore është një tjetër qasje që po përdoret gjerësisht në mbarë botën. Sigurimi i trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve për burrat mbi çështjet gjinore duhet të përfshijnë, mes tjerash, barazinë gjinore, rëndësinë dhe njohjen e pjesëmarrjes së grave në bujqësi, diskriminimin gjinor në qasjen në burimet bujqësore, rolet e shumëfishta të grave dhe nevojën për mbështetje.

Së fundmi, projekti duhet të vazhdojë të inkurajojë gratë të punojnë në bujqësi duke u ofruar atyre grante dhe mjete që ulin ngarkesën e tyre të punës, dhe më shumë seanca informuese për mundësi të ndryshme duhet të sigurohen për gratë që janë të interesuara të punojnë në bujqësi.

4 Rritja e vendimmarrjes tek gratë që punojnë në bujqësi

Projekti mund të lehtësojë rrjetëzimin e grave me zinxhirët e vlerave bujqësore, nga prodhimi deri në përpunimi dhe shitja, përmes forcimit të kapaciteteve të grave rreth vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes dhe duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet rreth jetesës së bujqësisë. Projekti duhet të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me Drejtoritë e Bujqësisë, të forcojë bashkëpunimin me Zyrtaret për Barazi Gjinore dhe organizata të tjera lokale që punojnë në çështje bujqësore dhe / ose gjinore.

Lidhjet me programe të tjera që punojnë në çështjet gjinore dhe bujqësinë duhet të forcohen, duke kontribuar kështu në rritjen e fuqisë vendimmarrëse të grave. Së fundmi, projekti mund të mbrojë që strukturat vendimmarrëse komunale të adresojnë nevojat e grave dhe të përmbajnë në bujqësi.

2) Përfshirja e të rinjve në bujqësi

Nuk ka asnjë hulumtim në Kosovë që synon të kuptojë interesimin e të rinjve për të punuar në bujqësi. Hulumtimet e fundit kanë treguar një rritje të dukshme në preferencat e të rinjve që të punojnë në sektorin publik, e raportuar nga 70% të të rinjve (FES, 2019). Për më tepër, i njëjti raport tregon se gati gjysma e të rinjve shqiptarë të Kosovës kanë një qëllim të moderuar deri shumë të fortë për të lënë Kosovën, ndërsa rreth 55% e serbëve të Kosovës përgjigjen në të njëjtën mënyrë.

Të dhënat anekdotale tregojnë se përfitimi i ulët, siguria e dobët e produkteve dhe rreziqet e larta janë vetëm disa nga arsyet që të rinjtë e Kosovës nuk janë të angazhuar në aktivitete bujqësore, janë duke braktisur zonat rurale dhe duke kërkuar migracionin si një mundësi. Këto arsye janë konfirmuar gjatë vizitave në terren në të dy komunat, dhe nga diskutimet në fokus grupe.

Secili i anketuar është pyetur se nëse të rinjtë janë të interesuar të punojnë në bujqësi dhe përgjigjet siguruan një të dhëna interesante se si bujqësia shihet edhe nga këndvështrimi i prindërve për fëmijët e tyre. Duket se të rriturit dhe të rinjtë ndajnë të njëjtin mendim për angazhimin e të rinjve në bujqësi. Ata mendojnë se të rinjtë në përgjithësi nuk janë të interesuar të punojnë në tokë, sepse nuk shihet si një sektor fitimprurës, dhe ajo që është më shqetësuese është se bujqësia nuk shihet si një punë e denjë për të bërë, dhe është më pak e dëshirueshme nga ana e të rinjve. Edhe prindërit priren të mos i angazhojnë fëmijët e tyre në punë bujqësore, përveç kur kanë shumë nevojë, si psh. gjatë sezonit.

Ndonjëherë të rinjtë madje mund të pengojnë punën e prindërve në bujqësi, veçanërisht në mbajtjen e bagëtive. Disa gra raportuan se arsyeja që nuk mbajnë bagëti është fëmijët e tyre nuk duan. Kjo patjetër që ka nevojë për hulumtime të mëtejshme dhe të thelluara për të kuptuar arsyet. Duke pasur parasysh që bujqësia në Kosovë ka potencial të jetë një nga sektorët më të mëdhenj ekonomik dhe të gjenerojë një zhvillim të gjerë ekonomik, duke siguruar shumicën e popullatës me mjete për të siguruar jetesën e tyre, kjo posedon një kërcënim serioz për të ardhmen e bujqësisë në Kosovë. Bujqësia duhet të konsiderohet si një pjesë e madhe e zgjidhjes së papunësisë së të rinjve.

Perceptimet lidhur me bujqësinë dhe imazhi mund të jenë gjithashtu një pengesë për punën e të rinjve në bujqësi, edhe atje ku ka mundësi reale për të zhvilluar këtë punë. Shpesh, të rinjtë në zonat rurale nuk e shohin potencialin e bujqësisë, sepse ata janë rritur në komunitetet e fermerëve të vegjël që janë ballafaquar me treg të pafavorshëm dhe faktorëve të mjedisit, me pak fitim dhe punë të vështirë fizike.

2.1 Përmirësimi i imazhit të bujqësisë

Bujqësia në Kosovë pothuajse nuk portretizohet kurrë në media si punë e denjë e një të riu, në mënyrë që të mos shihet si një punë jashtë-kohe, e padobishme dhe e vështirë. Ka nevojë që të

rritet ndërgjegjësimi dhe vetëdija e të rinjve që të shkohin bujqësinë si profesion, si një mundësi angazhimi në tregun e punës, në inovacion dhe të shohin bujqësnë si një biznes të mundshëm. Projekti mund të ndihmojë në ndërtimin e një imazhi më të mirë të bujqësisë tek një audiencë të gjerë dhe të lejojë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave në mes të rinjve dhe fermerëve të rinj.

2.2 Lehtësimi i qasjes në pronë dhe kredi

Duke pasur parasysh që qasja dhe pronësia në tokë e të rinjve është e kufizuar, marrja e kredisë për të blerë tokë është shumë e vështirë, dhe ka shumë të ngjarë e pamundur. Nevojiten financime inovative për bujqësinë dhe bizneset e vogla. Për shembull, ofrimimi i kredive të buta për të rinjtë që dalin me propozime inovative në bujqësi. Roli i IADK-së në këtë proces është të fillojë një dialog social i cili thekson vështirësitë e fermerëve, veçanërisht të grave dhe të rinjve në qasjen e tyre në kredi, në bashkëpunim me drejtoritë e bujqësisë. Sektori privat, posaçërisht bankat e zhvillimit rural, duhet të ftohen dhe angazhohen në mënyrë aktive në këtë dialog social.

Për më shumë, të rinjtë duhet të mbështeten në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për mundësi të ndryshme mikrofinancimi, ose skema të ndryshme mbështetëse të granteve. Projekti mund të krijojë gjithashtu një skemë të veçantë të granteve për të rinjtë në bujqësi, si një pilot projekt, dhe nëse është e suksesshme, atëherë mund të bëhet shkallëzimi i tij në projekte ose iniciativa të tjera.

2.3 Përfshirja e tyre në dialog social

Të rinjtë duhet të angazhohen në takime konsultative për skema të ndryshme mbështetëse. Për më tepër, projekti mund të ndihmojë dhe lehtësojë angazhimin e të rinjve në diskutimet mbi politikat në nivelin lokal dhe të adresojë çështjet e imazhit të bujqësisë tek të rinjtë.

2.4 Lidhja e mediave sociale me bujqësi

Rritja e përdorimit të mediave sociale nga ana e të rinjve dhe qasja e tyre në teknologji mund të shfrytëzohet në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për rëndësinë dhe vlerën e bujqësisë. Përdorimi i këtyre kanaleve për të promovuar bujqësinë dhe edukimin e të rinjve mund të shkojë shumë larg në përfshirjen e grupeve të reja të njerëzve në sektor. Për më tepër, projekti mund të promovojë bujqësinë tek të rinjtë përmes prezantimit të tyre me modele pozitive (psh. sipërmarrësit e suksesshëm dhe të rinjtë në bujqësi).

2.5 Ofrimi i bursave, transportit pa pagesë dhe lidhjet me tregun e punës

Bashkëpunimi i forcuar midis donatorëve, institucioneve dhe sektorit të biznesit duhet të inkurajohet si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal për të promovuar më tej sektorin e bujqësisë, përfshirë OJQ-të bujqësore të drejtuara nga të rinjtë, të ngjashme me Këshillin e Veprimit Bujqësor në Lipjan dhe këshillat lokale të të rinjve.

Për më tepër, konsideroni mbështetjen për krijimin e diçkaje të ngjashme me "Shoqatën e Fermerëve të Rinjë", si një vend ku të rinjtë që merren me bujqësi bashkëpunojnë me njëritjetrin, përfitojnë nga aktivitete të ndryshme për gjenerimin e të ardhurave dhe potencialisht shesin produktet e tyre duke përdorur një markë të unifikuar, duke i bërë ata të rrisin kapacitetet e tyre konkurrese në treg.

Shtojca 1 – Referencat

Kosovo Agency of Statistics (2019). Labor Force Survey. Retrieved from: <https://ask.rks.gov.net/media/4927/labour-force-survey-q1-2019.pdf>

OSCE (2018). Municipality Profile. Retrieved from: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>.

FES (2019). Kosovo Youth Study. Retrieved from: <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15264.pdf>

Shtojca 2 – Pyetësi i anketës familjare

Ky pyetësor është anonim dhe asnjë e dhënë personale nuk do të mbahet
Qëllimi i përgjithshëm i analizës gjinore të bazuar në projekt të realizuar nga IADK është të krijojë një bazë të shëndoshë për projektin dhe të sigurojë që ndërhyrjet synojnë nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve duke siguruar mundësi të barabarta. Analiza do të paraqitet me rekomandimet përkatëse si bazë për hartimin e ndërhyrjeve të projektit të ardhshëm.

Vendi: _____.

Data dhe koha: _____.

Pjesëmarrësi: Mashkull____, Femër____, Mosha: _____

Statusi martesor: I/e pamartuar____ I/e martuar____ I/e vejë____ I/e divorcuar____.

Informata të përgjithshme për familjen

Statusi i punësimit:

____ I/e papunë duke kërkuar punë

____ I/e papunë duke mos kërkuar punë

____ I/e punësuar

____ I/e vetëpunuar

Niveli i edukimit (Niveli më i lartë i edukimit):

____ Pa shkollim

____ Shkolla fillore

____ Shkolla e mesme e ulët

____ Shkolla e mesme

____ Universiteti

____ Tjetër

Numri i burrave të rritur në familje: _____

Numri i grave të rritura në familje: _____

Numri i vajzave në familje (deri në moshën 18 vjeçare): _____

Numri i djemve në familje (deri në moshën 18 vjeçare): _____

I QASJE DHE KONTROLL NË RESURSE DHE ASETË

Pronësia e tokës dhe aktivitetet e zhvillimit bujqësor

1. A ka në pronësi familja juaj apo ju tokë bujqësore? Po ____, Jo ____

Nëse po, në emër të kujt është e regjistruar toka bujqësore:

____ Në emërin tim

____ Bashkëshortit/es

____ Edhe në emër timin edhe në atë të bashkëshortit

____ Nuk e di

____ Tjetër: _____.

2. Cilat janë disa prej barrierave për gratë që të kenë në pronësi tokë bujqësore? (Pyetje e hapur).

3. A merret familja juaj me aktivitete që lidhen me bujqësi? Po ____, Jo ____.

3.1 Nëse po, kush bën punë bujqësore në familjen tuaj?

____ Unë

____ Bashkëshorti/ja

____ Edhe unë edhe bashkëshorti/ja

____ Fëmijët

____ Të tjerët (të lutem specifiko): _____.

4. Produktet bujqësore përdoren për:

____ Konsum familjar

____ Shitje

____ Te dyjat

____ Tjetër (të lutem specifiko)

5. Kush i shet këto produkte bujqësore dhe kush e cakton cmimin?

____ Unë

____ Bashkëshorti/ja

____ Edhe unë edhe bashkëshorti/ja

____ Fëmijët

____ Të tjerët (të lutem specifiko): _____.

6. Nëse familja juaj shet produkte bujqësore, te kush i shitni ato?

____ Ndërmjetësuesi

____ Marketi lokal

____ Tjetër (Të lutem specifiko)_____.

7. A ka dikush në familjen tuaj biznes me bujqësi? Po ____, Jo ____.

7.1. Nëse po, në pronësi të kujt është biznesi?

- ___ Në emërin tim
- ___ Bashkësorti/es
- ___ Edhe në emër timin edhe në atë të bashkëshortit
- ___ Nuk e di
- ___ Tjetër: _____.

7.2 Nëse po, cfarë aktiviteti zhvillohet në biznes? (Pyetje e hapur).

8. Cilat janë disa prej sfidave dhe barrierave të grave për të hapur/ apo mbajtur/zhvilluar biznesin? (Pyetje e hapur).

Qasje në shërbime financiare

Pjesëmarrja në shërbimet financiare formale dhe jo-formale

9. A keni kërkuar ndonjëherë hua për ndonjë aktivitet që gjeneron të ardhura?

Po ____, Jo ____.

9.1. Nëse po, te kush? (Pyetje e hapur)

10. A keni kërkuar kredi në 12 muajt e fundit? Po ____, Jo ____.

10.1 Nëse po, ku keni aplikuar për kredi? (Pyetje e hapur).

11. Nëse nuk kemi marrë ndonjë kredi, cilat kanë qenë arsyet/barrierat që nuk keni marrë kredi? Cilat kanë qenë arsyet që ju është refuzuar kredia? (Pyetje e hapur).

12. A është vështirë për gratë që të marrin një kredi në bankë për të filluar dhe/apo rritur punën në bujqësi? Nëse po, cilat janë barrierat kryesore? (Pyetje e hapur)

12. Ku i marrin zakonisht gratë kreditë (bankat e mëdha, bankat mikro-financiare, bankat e orientuara në bujqësi, etj) – Pyetje e hapur

13. Në përgjithësi, për aktivitetet tuaja për krijimin e të ardhurave bujqësore, kush merr hua nga familja juaj dhe cilat janë disa nga kriteret që kërkojnë institucionet e financave? (Pyetje e hapur)

14. Në 12 muajt e fundit, a është prekur familja juaj nga:

Biznesi ka dështuar

Korrje e keqe për shkak të përmytjeve

Korrje e keqe për shkak të thatësirës

Humbja e korrjeve për shkak të sëmundjes së bimëve, insekteve, pushtimit të kafshëve, etj.

Vjedhja e mallrave

Sëmundja ose vjedhja e kafshëve

Dëmet që lidhen me situatën e koronavirusit

Të tjerë (të lutem specifiko): _____

15. Sa muaj kanë kaluar nga kjo ngjarje e ndodhur për herë të fundit?

16. Cili ishte ndikimi i kësaj ngjarje në situatën ekonomike të familjes?

17. A e ka tejkalu ekonomikisht familja këtë ngjarje? Nëse po, cilat janë disa nga strategjitë që kanë punuar për ju që të rikuperojeni?

Alokimi i resurseve në mes të djemve dhe vajzave

18. Nëse keni burime të kufizuara financiare, a do të investonit për djem apo vajza të familjes?

Ju lutem shpjegoni. (Pyetje e hapur)

19. Kush duhet të trashëgoj pronë në familje sipas jush dhe pse? (Pyetje e hapur).

2. PJESEMARRJA

Pjesëmarrja në aktivitete që lidhen me bujqësi

20. A jeni pjesë e ndonjë organizate/asociacioni/cooperative bujqësore/OJQ?

Po _____, Jo _____.

21. Cilat janë aktivitetet tuaja kryesore të grupit? Cilat janë rolet dhe kontributet e tyre?

A është kjo e ndryshme për burra dhe gra, vajza dhe djem? (Pyetje e hapur)

22. A jeni i angazhuar dhe / ose i ftuar në seanca këshillimi për politikën dhe strategjitë lokale të përdorimit dhe menaxhimit bujqësor? Po ____, Çfarë lloji? Jo ____.

23. A ka aktivitete apo nisma të komunitetit në fshat për të trajnuar për të zhvilluar teknika më të mira për punën bujqësore? Po ____, Çfarë lloji? Jo ____.

23.1 Nëse jo, mendoni se ky lloj aktiviteti është i nevojshëm për fshatin dhe familjen tuaj? Nëse po, pse dhe çfarë është e nevojshme

Po ____, Jo ____.

24. Nëse ka takime të organizuara në nivelin e komunitetit për çështje që lidhen me bujqësinë, kush merr pjesë nga familja?

___ Unë

___ Bashkëshorti/ja

___ Edhe unë edhe bashkëshorti/ja

___ Fëmijët

___ Të tjerët (të lutem specifikoj): _____.

25. Numëroni tri barriera kryesore që e parandalojnë pjesëmarrjen aktive të grave në sektorin e bujqësisë?

1) _____

2) _____

3) _____

26. Cilat informacione dhe aftësi specifike janë të nevojshme për gratë dhe të rinjtë për të marrë pjesë në hapësirat publike dhe vendimmarrjen e komunitetit? (Pyetje e hapur)

27. Çka e lehtëson pjesëmarrjen aktive të grave në bujqësi? (Pyetje e hapur)

28. A do të merrnin pjesë gratë në takime ku ka burra të pranishëm? Po ____, Jo ____, Varet (specifiko)

29. A preferoni të keni trajnime dhe takime vetëm për gratë?

___ Po

___ Jo

___ Nuk ka rëndësi për mua

___ Nuk e di

___ Tjetër (të lutem specifiko): _____.

30. Nëse nuk jeni i përfshirë në aktivitete bujqësore, cilat janë arsyet e mospjesëmarrjes?

___ Mungesë e kohës

___ Mungesa e njohurive se cka mundet të punohet

___ Mungesë transporti

___ Nuk kam tokë bujqësore

___ Kujdesi ndaj fëmijëve

___ Kujdesi ndaj të moshuarve

___ Nuk jam e interesuar

___ Më nevojitet leje nga burri

___ Tjetër (specifiko): _____

31. Sa kohë harxhoni në ditë / javë për detyra që nuk lidhen me bujqësinë? Listoni ato duke përfshirë edhe kohën e investuar në secilin aktivitet. (Pyetje e hapur)

32. Si ndikon përdorimi i kohës suaj në shkallën tuaj të aktiviteteve bujqësore (prodhimi, grumbullimi, përpunimi, etj)

3. NDARJA E PUNËS

33. Si ndahet puna në familjen tuaj? Kush bën çfarë? (Pyetjet do të bëhen në varësi të fushës së punës së të anketuarve).

Llojet e aktiviteteve	Unë	Bashkëshorti/ja	Tjetër (Specifiko)
-----------------------	-----	-----------------	--------------------

Blerja e farës			
----------------	--	--	--

Përgaditja e farës			
--------------------	--	--	--

Livrimi			
---------	--	--	--

Mbjellja			
----------	--	--	--

Fertilizimi			
-------------	--	--	--

Kultivimi			
-----------	--	--	--

Pastrimi i bimëve			
-------------------	--	--	--

Korrje			
--------	--	--	--

Procesimi			
-----------	--	--	--

Shpërndarja e produktit dhe shitja			
------------------------------------	--	--	--

Llojet e aktiviteteve	Unë	Bashkëshorti/ja	Tjetër (Specifiko)
-----------------------	-----	-----------------	--------------------

Ushqen bagëtinë
Mjelja
Kullotja e bagëtive
Dhënja e ujit
Trajtimi mjekësor i kafshëve
Ruajtja e ushqimit

Llojet e aktiviteteve	Unë	Bashkëshorti/ja	Tjetër (Specifiko)
Përgaitja e ushqimit			
Kujdesi ndaj fëmijëve			
Pastrimi i shtëpisë			
Mbledhja e drurëve			

Llojet e aktiviteteve (në varësi të llojit të punës së përpunimit të perimeve)	Unë
Bashkëshorti/ja	Tjetër (Specifiko)

Rritja
Prerja (zhveshja)
Larja primare
Larja sekondare (dezinfektimi)
Larja terciare (shpërlarje)
Prerja dhe copëtimi
Dehidrimi
Paketimi (vakumi)

34. Kush, nëse dikush, në familjen tuaj ka qasje dhe njohuri të teknologjive / pajisjeve bujqësore? Kush vendos, shumicën e kohës, nëse do të përdoren teknologjitë / pajisjet?

___ Unë
___ Bashkëshorti/ja
___ Edhe unë edhe bashkëshorti
___ Tjetër (specifiko): _____

35. Si e menaxhoni punën gjatë sezonit të pikut? Kush bën çfarë? (Pyetje e hapur)

36. A mendoni se në ditët e sotme burrat duhet të marrin pjesë më shumë dhe në mënyrë të barabartë në rritjen e fëmijëve dhe punët e shtëpisë me gratë? Ju lutem shpjegoni.

4. VENDIM-MARRJA

37. A keni përfituar nga ndonjë subvencion në bujqësi? Po ____, Jo ____.

37.1 Nëse po, prej kujt?

___ Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
___ Drejtorisë Komunale të Bujqësisë
___ IADK
___ Tjetër (specifiko): _____

38. Kush kontrollon paratë e fituara nga puna me produkte bujqësore?

- ☐ Unë
- ☐ Bashkëshorti im
- ☐ Të dytë
- ☐ Tjetër (specifiko): _____

39. Për cka përdoren të ardhurat?

- nevojat ditore (ushqim etj)
- strehim
- edukim për fëmijë
- riinvestimi në biznes
- Tjetër (specifiko)_____.

40. Kush merr vendime për aktivitetin bujqësor?

- ☐ Unë
- ☐ Bashkëshorti im
- ☐ Të dytë
- ☐ Tjetër (specifiko): _____

41. Kush mendoni se duhet të ketë fjalën e fundit në shtëpi?

42. Kush shkon në treg në familjen tuaj për të shitur produktet?

- ☐ Unë
- ☐ Bashkëshorti im
- ☐ Të dytë
- ☐ Tjetër (specifiko): _____

43. Cilat mundësi punësimi janë të hapura për gratë / vajzat, çfarë për burrat / djemtë në sektorin e bujqësisë? (Pyetje e hapur)

44. Cilat janë rezultatet për gratë / vajzat, burrat / djemtë, nëse gratë marrin me sukses vendime në lidhje me aktivitetin bujqësor, shitjen e produkteve etj.? (Pyetje e hapur)

45. Cilat mendoni se janë gjërat më të rëndësishme që ju nevojiten për të rritur të ardhurat dhe mirëqenien tuaj? (të prioritetizohen)

- ☐ Më shumë trajnime
- ☐ Më shumë pajisje
- ☐ Qasje më e mirë në informata
- ☐ Pajisjet dhe teknikat që zvogëlojnë ngarkesën time të punës
- ☐ Qasje më e mirë në markete
- ☐ Qasje më e mirë në transport, lëvizje
- ☐ Më shumë informacion dhe njohuri në lidhje me mundësi të tjera ekonomike
- ☐ Qasje më e mirë në kopshte
- ☐ Tjetër

46. A ka ndonjë fushë për të cilën jeni veçanërisht të interesuar të mësoni për të rritur gjenerimin e të ardhurave tuaja në bujqësi? (Pyetje e hapur)

47. Si e vlerësoni komoditetin e mjeteve të transportit për ju për të udhëtuar nga shtëpia juaj në tregjet urbane? (Pyetje e hapur)

48. Çfarë lloj vendimesh marrin pjesë gratë dhe burrat, vajzat / djemtë në familje (Pyetje e hapur)

49. Cilat zakone, politika dhe norma parandalojnë gratë / të rinjtë të marrin vendime më vete? (Pyetje e hapur).

50. Cilat janë rekomandimet tuaja për njësinë e zbatimit të projektit (IADK) në angazhimin e grave dhe të rinjve në sektorin bujqësor? (Pyetje e hapur)

Ndikimi i pandemisë në bujqësi

- Cilat janë disa nga vështirësitë që keni hasur si pasojë e bllokimit të koronavirusit? A ka ndonjë vlerësim të dëmeve të shkaktuara?
- A keni marrë ndonjë mbështetje nga qeveria ose donatorët për të kapërcyer vështirësitë financiare të shkaktuara gjatë kësaj periudhe?
- Cilat janë disa pengesa / vështirësi / nevoja unike me të cilat janë përballur gratë që punojnë në bujqësi gjatë kësaj kohe?
- Cilat janë disa nga strategjitë që ju do të përdorni për t'ju ndihmuar të qëndroni financiarisht në situata emergjente (të ngjashme me situatën aktuale).

Shtojca 3 – Pyetjet për institucionet lokale

Pyetësi për institucionet në nivelin lokal (Drejtoria Komunale e Bujqësisë dhe Zyrtarët për Barazi Gjinore)

Vendi: _____

Institucioni/Zyrtari: _____

Data: _____

1. Sa këshillues është procesi i planifikimit bujqësor dhe hartimit të politikave në nivelin lokal? A janë burrat dhe gratë të angazhuar në mënyrë të barabartë që nga fillimi në zhvillimin e politikave në nivelin lokal?
2. Sa të ndjeshme gjinore janë politikat bujqësore dhe në çfarë mase janë zbatuar?
3. A ka ndonjë masë apo politikë pozitive që favorizon regjistrimin e tokës bujqësore në emrin e grave?
4. A ka ndonjë masë apo politikë pozitive që favorizon angazhimin e grave në aktivitetet bujqësore dhe / ose subvencione?
5. A konsultohet institucioni (Drejtoria Komunale e Bujqësisë) me mekanizmat e barazisë gjinore në nivelin lokal në formulimin dhe zbatimin e politikave në sektorin e bujqësisë?

6. Çfarë kapacitete zhvillimore është i nevojshëm për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e zyrtarëve dhe vendimmarrësve në lidhje me menaxhimin financiar dhe burimeve njerëzore që përgjigjen ndaj gjinisë në sektorin e bujqësisë në nivelin komunal?
7. A ka një buxhet të veçantë të ndarë për aktivitete që kanë të bëjnë me gjininë në bujqësi?
8. Çfarë informacioni dhe të dhëna të ndara midis gjinive janë në dispozicion për pronën e tokës dhe grante / përfitime / subvencione?
9. Cilat janë nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemve në sektorin e bujqësisë?
10. Cila është puna e zyrtarëve për barazi gjinore në integrimin e gjinisë në bujqësi? (vetëm për oficerët e barazisë gjinore).
11. A ka pasur përpjekje për të marrë informacion nga organizatat dhe grupet e përdoruesve të bujqësisë dhe aleancat e grave dhe ekspertët për të vlerësuar ndikimin diferencial të politikave bujqësore mbi gratë dhe burrat në komunat përkatëse? (vetëm për oficerët e barazisë gjinore).
12. A kanë bashkëpunuar zyrtarët e barazisë gjinore me ndonjë OJQ (qofshin ato qendrore apo lokale) në adresimin e çështjeve gjinore në bujqësi? (vetëm për oficerët e barazisë gjinore).
13. A kanë kryer zyrtarë të barazisë gjinore ndonjë sesion informacioni për rritjen e ndërgjegjësimit të grave rurale për të drejtat e tyre të trashëgimisë?
14. A përballen gratë kufizime të veçanta për të hyrë në hyrje, kredi dhe përdorim të tokës?
15. A mund të kufizojnë ekzistencën e barrierave ekzistuese për gratë ose familjet me në krye gratë?
16. Cilat janë rekomandimet tuaja për Njësinë për Implementimin e Projektit, si mund të promovojë projekti barazinë gjinore dhe të zvogëlojë boshllëqet gjinore në komunitetet përfituese?

Shtojca 4 – Pyetjet kyqe për organizatat locale

Pyetësori për organizatat me bazë në komunitet

Vendi: _____

Organizata: _____

Personi përgjegjës: _____

Data: _____

1. A ka organizata juaj aktualisht ndonjë aktivitet dhe / ose projekt që synon gratë dhe të rinjtë që punojnë në sektorin e bujqësisë?
2. A ka organizata juaj aktualisht ndonjë aktivitet dhe / ose projekt që synon gratë dhe të rinjtë që punojnë në sektorin e bujqësisë?
3. A këshilloheni me njerëz në nivelin bazë për nevojat dhe kërkesat e tyre përpara se të zhvilloni ndonjë aktivitet avokimi ose ndërgjegjësimi me gratë dhe të rinjtë rurale?
4. Nga këndvështrimi juaj, cili është interesi i grave dhe të rinjve për t'u përfshirë në aktivitete që lidhen me bujqësinë? Farë mund të bëhet për të rritur angazhimin e tyre?
5. Nga përvoja juaj në këtë fushë, si marrin gratë dhe të rinjtë informacione për aktivitetet dhe përfitimet që lidhen me bujqësinë?

6. Nga këndvështrimi juaj, cili është interesi i grave dhe të rinjve për t'u përfshirë në aktivitete që lidhen me bujqësinë? Farë mund të bëhet për të rritur angazhimin e tyre?
 7. Nga përvoja juaj në këtë fushë, si i marrin gratë dhe të rinjtë informacionet mbi aktivitetet dhe përfitimet që lidhen me bujqësinë?
 8. A ka ndonjë formë koordinimi me median lokale në ofrimin e informacionit për gratë dhe të rinjtë rurale për financime dhe mundësi të ndryshme trajnimi në bujqësi?
 9. Cilat janë nevojat e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në sektorin bujqësor të komunës tuaj?
 10. Cilat janë pengesat kryesore të angazhimit të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në sektorin e bujqësisë?
 11. A mendoni se një perspektivë gjinore është përfshirë në proceset e hartimit të politikave lokale?
 12. A ka organizuar organizata juaj ndonjë trajnim për të drejtat pronësore të grave në zonat rurale?
 13. Cilat janë rekomandimet tuaja për njësinë e zbatimit të projektit (IADK) për angazhimin e grave dhe të rinjve në sektorin bujqësor?
-